



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (çështje e shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 15.02.2024, 29.02.2024 dhe 13.03.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.**
6. **Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.**
7. **Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
8. **{...}, Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**
9. **{...}, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**
10. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. (çështje e shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 15.02.2024, 29.02.2024 dhe 13.03.2024)

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Për shkak të një angazhimi institucional, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë prezent në këtë mbledhje, kështu që mbledhja do të drejtohet nga unë z. Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu ju njoftoj se z.

Kurushi tek pika e parë e rendit të ditës nuk mund të marrë pjesë për shkak të deklarimit të konfliktit të interesit. Për shkak të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Për më tej vazhdojmë me pikën e parë të saj që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila është një seancë e shtyrë nga mbledhje të tjera.

Ftoj administratën për të njoftuar palët, pjesë e kësaj seance dëgjimore.

(Hyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj seance dëgjimore, konstatojmë faktin që znj. {...} është prezent, si përfaqësuese e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e cila është e autorizuar me autorizimin {...}, datë 15.02.2024, ndërkohë që konstatojmë që zonja {...} si magjistrate personalisht nuk është paraqitur, gjithashtu nuk është paraqitur dhe zonja Kola si avokate e cila disponon një prokurë të përgjithshme, por ditën e djeshme ka bërë një shkresë në të cilën kërkon shtyrjen e kësaj seance dëgjimore për faktin se nuk është pajisur ende me një prokurë të posaçme nga zonja {...}.

Ftoj përfaqësuesen e ILD-së në lidhje me propozimin për vijimin e kësaj procedure disiplinore në këtë seancë dëgjimore.

{...}: Në lidhje me faktin që përfaqësuesja ose vetë zonja {...} nuk është paraqitur, duke i bërë një analizë të gjithë procesit, që nga momenti kur ka filluar hetimi disiplinor ndaj kësaj magjistrateje, magjistratja në ILD ka qenë indiferente në lidhje me të gjitha njoftimet, ka pranuar njoftimet, ka kthyer përgjigje me postë por nuk ka paraqitur parashtrime. Në përfundim të procesit kur ka filluar procesi disiplinor në KLGJ magjistratja ka paraqitur disa kërkesa. Një nga kërkesat e para që ka sjellë vetë magjistratja, ka sjellë parashtrësia në lidhje me hetimin disiplinor të zhvilluar ndaj saj.

Në seancën e parë të zhvilluar në KLGJ magjistratja parashtrroi që nuk do të

merrte pjesë në këtë seancë pasi ishte e sëmurë dhe do të paraqitej avokatja mbrojtëse e saj. Duke zbatuar procedurën kjo seancë u shty.

Në seancën tjetër, të cilën përsëri avokatja e saj u paraqit me një prokurë të përgjithshme që nuk plotësonte kushtet e prokurës në lidhje me procedimin/hetimin disiplinor të zhvilluar pranë KLGJ-së, nga ana e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, avokates iu la një kohë e mjaftueshme kohë të cilën ajo e përcaktoi vetë. Ajo tha që brenda tre javëve unë do marrë prokurën dhe do paraqitem në seancë. Nga ana e ILD-së na duket një mungesë totale mund të them të magjistrates subjekt hetimi disiplinor. Gjithashtu, nga kryesuesi i seancës (jo seancës së kaluar, një seancë më përpara) u parashtrua që magjistratja të merrte pjesë vetë në këtë procedim disiplinor. Megjithatë, përfaqësueses së saj iu la një kohë më se e mjaftueshme trejavore për t'u paraqitur me prokurë në këtë seancë.

ILD-ja mendon që kjo seancë duhet të zhvillohet duke paraqitur parashtrësit e veta, si dhe konkluzionet përkatëse.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Atëherë lidhur me vijueshmërinë e kësaj seance dëgjimore, ju ftoj të largoheni me qëllim që Këshilli të marrë një vendimmarrje të vijueshmërisë (duke pritur).

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë me sa u parashtrua nga përfaqësuesja e ILD-së parashtrohet fakti që ky procedim disiplinor apo kjo seancë dëgjimore të vazhdojë në mungesë të magjistrates. Keni diskutime?

Ridvan Hado: Unë propozoj vazhdimin e seancës, vazhdimin e procedimit disiplinor të magjistrates {...}, pasi ka disa seanca që shtyhet. Ajo ka marrë dijëni në adresën e vet elektronike, po ashtu edhe në adresën e avokates, adresë të cilën na e ka dhënë për të njoftuar atë. Ne avokates i dhamë kohën e mjaftueshme, edhe zonjës {...}, që ose të paraqitet vetë ose të autorizojë përfaqësuesen e saj. Koha ka qenë më se e

mjaftueshme. I bie që zonja {...} s'ka interes për të marrë pjesë në procedim, në këto kushte unë propozoj që të vazhdojmë seancën procedimore. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Edhe unë jam dakord me sa tha zoti Hado. Ne i kemi dhënë mundësi zonjës {...} për t'u paraqitur në disa seanca. Kjo e fundit ka marrë njoftim rregullisht për sa kohë që njoftimi në prokurën e përgjithshme është parashikuar si një nga mjetet e njoftimit është edhe nëpërmjet përfaqësueses që ishte pajisur me prokurë të përgjithshme, që në prokurë kishte edhe tagrin për të marrë njoftimet, kjo e fundit nuk ka parashtruar asnjë shkak të ligjshëm që mund të vlerësohet pse nuk është pajisur me prokurë dhe e gjithë sjellja e saj konsiderohet se ka qëllim zvarritjen e këtij procedimi disiplinor. Për këtë arsye unë jam për vijimin e gjykimit, pasi nuk ka asnjë shkak për të përligjur mungesën si të magjistrates si edhe të një përfaqësuesi që mund të zgjidhte kjo e fundit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

Po, zonja Luli!

Fatmira Luli: Jam dakord me propozimet që bënë kolegët kështu që gjykoj që duhet ta hedhim në votim dhe të vendosim.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor që ky procedim disiplinor të vazhdojë në mungesë të magjistrates, në të cilën faktohet që i ka pas të gjitha rrethanat objektive dhe subjektive për të paraqitur një përfaqësues ligjor me prokurë të posaçme, në eventualitet të faktit që nuk mund të jetë personalisht në këtë seancë dëgjimore.

Vazhdojmë me votimin e propozimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Për ekonomi të kohës ftoj administratën që të ftojë përfaqësuesen e ILD-së.

(Rihyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}).

Ilir Rusi: Atëherë prezent znj. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendim që kjo seancë dëgjimore e procedimit disiplinor të vazhdojë në mungesë të magjstrates znj. {...}.

Ftoj përfaqësuesen e ILD-së znj. {...} për vijueshmërinë më tej të këtij procedimi.

{...}: Jo, i kam gati, edhe parashtrirat edhe konkluzionet.

Të kaloj shkurt.

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse ju deklaruat që i keni me shkrim konkluzionet, në këtë rast paraqitini në mënyrë sintetike.

{...}: Në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij procedimi disiplinor rezultoi e provuar se magjistrate {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka kryer shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2 shkronja “b” e Kushtetutës.

Në rastin konkret rezulton të plotësohen kushtet e parashikuara si shkelje disiplinore, pasi magjistrati subjekt hetimi disiplinor me dashje ka kryer veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të parashikuar nga neni 319/ç - 25 i Kodit Penal. Magjistratja është dënuar me vendim nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së

Parë për Korrupsion me vendimin penale nr. 69, datë 15.12.2022 i cili ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurës {...}, dënimin përfundimtar të saj dhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit. Ky vendim nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është ekzekutuar me urdhrin datë 15.12.

Në analizë të të gjitha fakteve dhe analizë të të gjitha provave arrijmë në përfundimin se veprimi i gjyqtarës {...} ka cenuar rëndë veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë për të siguruar integritetin jo vetëm gjyqtarëve por të gjithë sistemit.

Lidhur me kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, në analizë të shkallës dhe fajësisë, referuar të gjitha fakteve, vepra është kryer me dashje direkte. Nga analiza e të gjithave rezulton se për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: Gjyqtari duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi dhe vendimi të jetë i formës së prerë, siç e përmendëm edhe më lart, vendim i cili është ekzekutuar.

Nga analiza ligjore përsëri e këtyre fakteve, duke mbajtur në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore atë të kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë; fakti që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën shkelje të rëndë disiplinore, provohet se magjistrate {...} ka diskredituar pozitën dhe figurën e magjistratit duke cenuar imazhin e drejtësisë.

Për këtë arsye, për sa më sipër i kërkojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor të administrojë të gjitha provat e paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në këtë procedim disiplinor, në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/ 2016, kërkojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Caktimin ndaj magjistrate {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, e Kushtetutës, neni 104, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 të ndryshuar, masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Ftoj anëtarët nëse kanë ndonjë diskutim për momentin.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ju lutem zonja {...} të largohet, për të diskutuar Këshilli për vijueshmërinë më tej të këtij procedimi.

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë jemi në një fazë procedurale për të cilën vazhduam këtë procedim disiplinor në mungesë të zonjës {...} për rrethanat në të cilën morëm vendimmarrje. Përfaqësuesja e ILD-së ka shprehur konkluzionet dhe qëndrimin e vet. Ftoj anëtarët për diskutime të mëtejshme në lidhje me këtë procedim.

Atëherë në vijim të këtij procedimi, zonja Plaku kërkon fjalën.

Irena Plaku: Atëherë, pasur parasysh se Inspektori i Lartë i Drejtësisë dha edhe konkluzionet, unë them të kalojmë tek administrimi i provave dhe të shprehemi si për kërkesat ashtu edhe për të gjithë procesin, procedurën disiplinore që kemi në shqyrtim.

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Fatmira Luli: Atëherë edhe unë jam dakord që të procedohet duke administruar provat dhe duke u shprehur për kërkesën që ka bërë paraprakisht sepse ajo ka marrë dijenë, ka pas tërë mundësinë e duhur për të marrë pjesë në këtë proces vetë dhe nëpërmjet avokates. Nuk ka referuar për shkaqe pse nuk ka pajisur prokurën. Kohën për të pajisur me prokurë avokaten ia lamë siç deshtë vetë, me kërkesë edhe të avokates dhe të saj. Kështu që kemi përmbushur të tëra kushtet për ta njoftuar për të marrë pjesë në këtë proces dhe nuk ka dashur. Në këto kushte jam dakord të administrohen provat dhe të procedohet me vendimin.

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga anëtarët në lidhje me administrimin e provave të këtij procedimi disiplinor.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Në vijim, ka diskutime të tjera?

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim magjistratja {...} ka bërë një kërkesë për pezullimin e këtij procedimi sipas perceptimit dhe shkresave të bëra deri në përfundimin e gjykimit të saj në eventualitet të rekursit nga Gjykata e Lartë.

Keni diskutime për këtë rast?

Po zonja Plaku, fjala për ju!

Irena Plaku: Unë mendoj se nuk jemi në kushtet e pezullimit për sa kohë që vendimi merr formë të prerë në apel, pavarësisht qëndrimit të Gjykatës së Lartë. Mendoj se referohet para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, gjithashtu ka edhe praktikë të unifikuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me faktin se kur merr formë të prerë dhe kur është i ekzekutueshëm një vendim gjyqësor. Kështu që unë jam për refuzimin e kërkesës për pezullimin e gjykimit/procedimit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e propozimit të zonjës Plaku.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord, po me të njëjtin arsyezim. Neni 462, i Kodit të Procedurës Penale përcakton vendimet, në pikën 3, përcakton vendimet e formës së prerë, vendimin e gjykatës së apelit dhe të referon tek neni 428, pika 2/a “vendimet e lëna në fuqi”. Në

këtë rast jemi përpara një vendimi të lënë në fuqi për një krim, kështu që s'jemi para kushteve për pezullimin e vendimit. Faleminderit!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Në vijim të shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesen për t'i komunikuar vendimmarrjen e deritanishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Rihyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Ilir Rusi: Prezent zonja {...}, përfaqësuese e ILD-së.

Në eventualitet, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që kjo seancë dëgjimore dhe ky procedim disiplinor të vazhdojë në mungesë të magjistrates znj. {...}. Gjithashtu ju bëj me dije që ka marrë vendim për të administruar provat e dorëzuara nga palët në proces. Njëkohësisht vendosi edhe rrëzimin e kërkesës së magjistrates {...} për pezullimin e këtij procedimi në lidhje me konceptin dhe qëndrimin për marrje e vendimit të formës së prerë dhe ekzekutimit të tij.

Në vijim të këtij procedimi disiplinor, ju ftojme juve si përfaqësuese e ILD-së për të shprehur konkluzionin përfundimtar dhe nëse keni ndonjë kërkesë tjetër procedurale në lidhje me këtë proces.

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Ashtu siç përmendëm edhe në parashtrime, Inspektori i Lartë, me vendimin nr. 3408/1, datë 20.12.2023, vendosi: "Fillimin e hetimit disiplinor..." duke ia kaluar të gjitha dokumentet dhe aktet në përfundim të këtij hetimi disiplinor, Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në analizë të identifikimit të të gjithë elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë ekzistencën e shkeljes disiplinore, në përfundim Inspektori i Lartë i Drejtësisë

i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor në këtë procedim disiplinor, në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/ 2016 “Për statusin”, caktimin ndaj magjstrates {...} të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Në formalitet të procedurës, ju ftoj përsëri të largoheni me qellim që Këshilli të disponojë me diskutimet dhe me vendimmarrjen përkatëse. Faleminderit!

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Ilir Rusi: Me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare nga përfaqësuesja e ILD-së, atëherë ky shqyrtim i procedimit disiplinor, si në formë dhe në thelb ka përfunduar, kështu që hedh fillimisht në votim faktin nëse është e plotë procedura apo jo.

Irena Plaku: Atëherë jam dakord t’i jepet fund procedimit disiplinor dhe të tërhiqemi për të shpallur vendimin.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ky votim ka të bëjë me plotësimin e procedurës.

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me votimin në lidhje me propozimet e bëra nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në lidhje me shkarkimin e magjstrates znj. {...}.

Irena Plaku: Atëherë, unë jam dakord me kërkesën e ILD-së dhe jam dakord për pranimin e kërkesës duke vendosur shkarkimin e gjyqtarës {...}.

Gentiana Muçaj: Jam dakord për pranimin e kërkesës së ILD-së duke i dhënë masë disiplinore “Shkarkim nga detyra” magjstrates {...}.

Ridvan Hado: Po ashtu edhe unë, dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord me pranimin e kërkesës dhe shkarkimin e magjistrates.

Markelian Koça: Dakord me kërkesën.

Yllka Rupa: Pro kërkesës për shkarkim.

Emona Muçi: Pro kërkesës.

Ilir Rusi: Dakord.

Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesen e ILD-së për t'i komunikuar vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Rihyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Ilir Rusi: Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me shkarkimin nga detyra të magjistrates zonjës {...}.

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare të datës 13.03.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. {...}, Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 9. {...}, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 10. {...}, gjyqtar.*
- 11. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare të datës 13.03.2024).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite.

Ju bëj me dije që zoti Kurushi është prezent në vijueshmëri të kësaj mbledhjeje,

për shkak të deklarimit të konfliktit të interesit që kishte në pikën e parë në lidhje me përmbajtjen e saj.

Vazhdojmë me pikën 2 që është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Ftoj administratën të bëjë me dije përfaqësuesen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. {...}, që njoftohem që është prezent.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Prezent znj. {...} e cila është pajisur me autorizimin nr.{...}, datë 05.04.2024 e cila është inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e cila do të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr. 3/2024 në ngarkim të magjistratit {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në datë 09.04.2024.

Prezent është edhe z. {...}.

Për më tej ftoj përfaqësuesen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vijueshmërinë e këtij procedimi disiplinor.

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Më datën 15.01.2024 në median e shkruar dhe atë vizive është publikuar një video e realizuar në emisionin investigativ “Stop” të televizionit Klan me titull “Gjyqtari i Vlorës jep me qira dhe shet gjyqe”. Në analizë të pamjeve filmike, videove të publikuara rezulton se magjistrati {...} me detyrë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është filmuar me bisedime me një person tjetër të paidentifikuar objekt i të cilës është marrja me qira e një ambienti zyrë në pronësi të gjyqtarit.

Ilir Rusi: Herën e fundit, seanca është shtyrë me qëllim që ne të bëhemi me dije me vendimin e arsyetuar të KPK-së. Në lidhje me këtë, çfarë qëndrimi keni?

Merr fjalën zoti {...}:

{...}: Kam bërë kërkesë për pezullimin e procedimit pasi është shprehur në datë 13 KPK-ja për masën që barazohet me masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pavarësisht se u sqaruan të gjitha problemet siç thoshte edhe ILDKPI-ja që s'ka fshehje të pasurisë, s'ka deklaram të rremë, s'ka konflikt interesi. Unë i qartësova të gjitha dhe u habita me vendimin përfundimtar. Se unë kisha hequr dorë vetë. Thjesht e dija që do kaloja KPK-në me dokumentacionin që kisha. Paqartësitë e dokumentacionit unë i sqarova. Çova dokumentat origjinale që askush nuk i ka këto dokumenta, që pretendoshesh që nuk kam paguar tatimet si avokat, janë të gjitha dokumentat origjinale të kohës, autentike, që mund t'i cekoni me një ekspert, dokumenta që unë mburresha me këto dokumenta që jam i vetmi që i kam mbajtur që nga viti '90, dokumentat origjinale. Ata nuk mi njohën. Për konfliktin e interesit patëm probleme, i njëjti fakt që pretendohet edhe nga ILD-ja që në 150 avokatë që ka pas Vlora, 5-6 avokatë bashkëshortja ime i ka dhënë me qira, për faktin se kanë qenë afër.

(Anëtarja znj. Luli e pyet nëse i është komunikuar vendimi.)

{...}: Është komunikuar me e-mail shkurtimi i vendimit "Shkarkimi nga detyra" dhe vendimi përfundimtar i arsyetuar nuk ka dalë akoma.

Edhe unë sot erdha për kërkesën paraprake, duke pasur parasysh që ligji e ka të qartë. Mendova që do administrohej nga KLGJ-ja vendimi i KPK-së. Por ajo dihet botërisht, dihet botërisht që vendimi është shpallur.

Ilir Rusi: Çfarë kërkonte në vijimin e këtij procedimi?

{...}: Pezullimin e këtij vendimi.

Janë disa vendime edhe nga ana e juaj të mirarsyetuara bindëse, i kam lexuar, dhe jam dakord me pezullimin e masës, derisa të shprehet KPA-ja. Unë e kam bindje se në KPA, unë dokumentacionin e kam të qartë, bile jam kthyer thjesht vetëm për akuzat që

më ishin bërë. I kam të gjitha në rregull, absolutisht. I kam thënë edhe atyre që as në Evropë nuk gjejnë gjyqtarë si unë, të kenë gjykuara 20 seanca në ditë për 23 vjet, të ketë pasur në 20 mijë çështje të gjykuara, 20 ankesa gjithsej. Kam dalë jashtë shtetit vetëm 5 herë. Të tjerët kanë dalë nga 5 herë në vit.

Ilir Rusi: Dakord zoti {...}, dakord.

Ju e shprehët qëndrimin tuaj, dakord.

Po, zonja {...}!

{...}: Në lidhje me kërkesat paraprake që paraqiti subjekti {...}, dua të parashtroj që ligji 96...

{...}: Më fal, {...}. Se gjithë kohës si avokat e kam pasur në gjendjen civile {...}. Më kanë kërkuar {...} dhe akuzoni në gjendje civile {...} s'ka punuar avokat fare. Duke qenë edhe palë në gjykim.

{...}: {...}. Ok!

Ligji 96/2016 “Për statusin” ka parashikuar kompetencat në lidhje me ushtrimin të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu legjislacioni dhe Kushtetuta ka parashikuar dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i cili është një komision për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në këto kushte duke parë që ka një mbivendosje të juridiksionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke iu referuar ligjit 96/2016, kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë parashikuar shumë qartë ashtu edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kërkojmë rrëzimin e kërkesës së magjistratit {...}. Pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, 103, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, të ndryshuar dhe caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ju ftoj të largoheni për momentin me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet përkatëse.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim fjala për ju zoti Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Në kushtet kur në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është botuar dispozitivi i vendimit për shkarkimin, nga ky komision, i {...}, i propozoj mbledhjes plenare pezullimin e procedimit disiplinor nr.3/2024 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, derisa të marrë formë të prerë vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i datës 13.03.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Hedhim në votim propozimin e z. Hado.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ftoj administratën të bëjë me dije palët për të qenë prezent.

(Rihyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Në lidhje me këtë procedim disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

Pezullimin e procedimit disiplinor nr.3/2024 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në lidhje me shkarkimin e z. {...}.

Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.

Një kopje e vendimit i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 11. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 12. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 13. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 14. Irena Plaku | (anëtare) |
| 15. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 16. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 17. Alban Toro | (anëtar) |
| 18. Markelian Koça | (anëtar) |
| 19. Emona Muçi | (anëtare) |
| 20. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami.***

20

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.04.2024 (Pika 3)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

12. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

13. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

*14. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj
Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

15. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

16. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.

17. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.

18. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)

19. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Mbi zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 5/2024, të filluar ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Komisioni Disiplinor sjell para mbledhjes plenare procedimin disiplinor të nisur

më datë 05.04.2024 të ILD-së me shkresën nr. {...} prot., datë 05.04.2024 me objekt fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", [...].

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë propozon caktimin e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra" ndaj magjistrates znj. {...} sipas parashikimeve të nenit 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja "b" të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin".

Referuar nenit 63 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit.

Lidhur me procedurën, Komisioni Disiplinor propozon që në referim të nenit 16 të vendimit nr. 316 datë 14.09.2020 të Këshillit, ku duhet të marrin pjesë tre anëtarët e përhershëm të Komisionit Disiplinor, konkretisht znj. Gentiana Muçaj, z. Ilir Rusi dhe z. Ridvan Hado. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado.

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Ftoj administratë për hedhjen e shortit sipas mekanizmit të propozuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Në një vazo futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Ridvan Hado, z. Ilir Rusi dhe znj. Gentiana Muçaj.

Procedura e përzgjedhje:

Relator përzgjidhet z. Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Keni diskutime mbi mënyrën e hedhjes së shortit?

Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit sipas përditësimit të përmbajtjes së shortit të hedhur së fundi.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ilir Rusi në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 5/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistrates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022”, relatore znj. Yllka Rupa.¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
7. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022”, relatore *znj. Yllka Rupa*.

Ilir Rusi: Në vijim, meqenëse seanca për z. Dosti është përcaktuar në orën 13:00, po vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022”, për të cilin është përgatitur akti përkatës nga relatore *znj. Rupa*. Gjyqtari ka bërë ankim të pjesshëm të raportit. Për më tej fjalën relatores *znj. Rupa*.

Gjithashtu, a është prezent z. {...}?

Nëse nuk është prezent vazhdojmë.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Të nderuar kolegë, në cilësinë e relatores po paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, raport i cili ka për qëllim vlerësimin e shkallës

së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale. Periudha e vlerësimit është 2020-2022.

Në projektraport paraqitet e plotë procedura. Kështu që unë në formë konkluzionesh do prezantoj nivelin e pikëzimit dhe vlerësimit për gjithsecilin nga katër kriteret, duke filluar me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”.

Në lidhje me 1.A.a Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, evidentohet aftësia e lartë e gjyqtarit në drejtim të identifikimit të normës konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e normave në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizën ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Lidhur me 1.A.b Aftësitë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Në tërësi referuar të dhënave rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo edhe për ato që shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës përpara aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Vihet re gjithashtu një kujdes i lartë i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës në aspektin procedural ashtu edhe në atë thelbësor. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë dhe pikëzimi me 20 pikë (*në tabelën e vlerësimit është 25, pra është lapsus në raport*).

Për të kaluar tek 1.B Arsytimi ligjor, për sa i takon 1.B.a Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit, rezulton se gjyqtari kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Propozohet për këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 15.

Gjithashtu edhe në lidhje me 1.B.b Strukturën e qëndrueshme dhe të mirë organizuar e vendimit gjyqësor, gjyqtari ndjek në hartimin e vendimeve një strukturë të

qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet në prezumimin e fakteve me natyrë procedurale dhe atyre thelbësore, identifikimin e ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit duke ndarë pjesët përshkruese, arsyetuese në nënndarje, gjithashtu identifikon ato me tituj. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikët 10.

Lidhur me 1.B.c Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, gjyqtari ka aftësi shumë të mira në lidhje me këtë tregues. Në secilin vendim të analizuar mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë është i plotë dhe merr në analizë dhe jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikët 20 *(në tabelën e vlerësimit është 25, pra është lapsus në raport).*

Kështu që niveli i vlerësimit për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me 2. Aftësitë organizative të gjyqtarit, në lidhje me 2.A.a. Respektimin e afateve ligjore, në total, nga 81 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre, rezulton se gjyqtari ka përfunduar jashtë afatit ligjor 68 çështje ose rreth 17.5% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Lidhur me pikëzimin e këtij treguesi është vlerësuar gjithashtu kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret rezulton se gjyqtari ka pasur edhe një ngarkesë të lartë çështjes për të gjithë periudhën e vlerësimit, pasi në total ka gjykuar 1366 çështje nga të cilat 807 çështje me palë kundërshtarë. Në këto kushte unë propozoj pikëzimin maksimal për këtë tregues.

Lidhur me 2.A.b. Plotësimin e standardeve minimale kohore, referuar tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit rezulton se nga 998 çështje të përfunduara përgjatë periudhës së vlerësimit për të cilat zbatohet standard minimal kohor, 202 prej

tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 20.2% e çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor. Duke iu referuar gjithashtu tabelave me të dhëna statistikore, për 53 çështje të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor në disa raste rezulton se vonesa për shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtari (pra është muaji gusht i viteve përkatëse 2020-2021-2022) si dhe periudha e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore prej një muaji e 17 ditë për shkak të pandemisë Covid. Nëse në llogaritjen e afateve të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtari ka qenë me leje vjetore dhe periudha e pezullimit, atëherë për disa prej tyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor. Bëhet fjalë për 53 çështje. Secila prej tyre është analizuar në mënyrë të detajuar në projektraportin e vlerësimit. Kështu që bazuar në analizën e këtyre të dhënave rezulton se nga 998 çështje të përfunduara përgjatë periudhës të vlerësimit, për të cilat zbatohet standard minimal kohor, 149 prej tyre ose 14.9% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi dhe sipas metodologjisë kjo përqindje vlerësimi vlerësohet me 4 pikë. Duke pas në konsideratë edhe disa aspekte të tjera, rrethana të cilat nuk varen nga gjyqtari (nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit), unë propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtari të vlerësohet në nivelin maksimal të pikëve, pra me 5 pikë.

Lidhur me Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, si krahasim koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë me standardin minimal në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër për 7 nga 10 kategoritë e çështjeve të analizuara. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për 3 kategori çështjesh. Janë çështje familjare pa palë kundërshtarë e përfunduar për 78.1 ditë. Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë përfunduar prej 184,6 ditë dhe kërkesa penale në fazën e ekzekutimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, për 66.3 ditë duke u tejkualuar ky afat respektivisht me 18.1 ditë, 4.6 ditë, dhe 6.3 ditë, tejkalime të cilat mund të konsiderohen të papërfillshme duke marrë në konsideratë faktin që gjyqtari ka gjykuar një numër të madh çështjesh për këtë periudhë. Kështu që propozoj lidhur me vlerësimin e këtij treguesi nivelin e pikëzimit me 5, pra pikëzimin maksimal.

Lidhur me 2.A.ç. Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore, për këtë tregues duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari për periudhën e

vlerësimit të ketë një rendiment prej 134.5% dhe si i tillë, kjo përquindje justifikon pikëzimin me 10 pikë sipas metodologjisë së vlerësimit.

Lidhur me 2.A.d. Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor rezulton më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, por duke pas në vlerësim rrethanat që nuk varen nga gjyqtari dhe që mund të kenë ndikuar në kohën e arsyetimit të vendimeve, janë të analizuar ato në projektraportin e vlerësimit, propozoj aplikimin e koeficientit 20%, për pasojë pikëzimin me 15 pikë të gjyqtarit lidhur me këtë tregues.

Për të kaluar tek 2.B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore 2.B.a. Numri mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.3 seanca dhe gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Kështu që propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët 15.

Lidhur me 2.B.b. Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, në tërësi referuar të dhënave dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor. Siç konstatohet gjyqtari ka respektuar të gjitha aspektet procedurale të rëndësishme për zhvillimin e gjykimit dhe vlerësoj se në lidhje me këtë tregues duhet të vlerësohet në nivel vlerësimi shumë të lartë, pikët 20.

Lidhur me 2.C. Aftësitë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore, për sa i takon 2.C.a. Rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Kështu që propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi lidhur me këtë tregues, pikët 5.

Për sa i takon 2.C.b. Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete por konstatohet mungesa e “Letrës së të drejtave” e

cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim. Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtime me të cilat jeni njohur, por pavarësisht se të drejtat e parashikuara në nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.Penale subjekteve i janë garantuar duke iu bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mosadministrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes. Dhe duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur tashmë nga këshilli lidhur me këtë aspekt, propozoj nivelin e vlerësimit lidhur me këtë tregues “mbi mesatare”, pikët 8 për gjyqtarin.

Në lidhje me “Aftësitë organizative të gjyqtarit” propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 98.

Për sa i takon “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”. Lidhur me “Etikën në punë”, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 35.

Lidhur me “Integritetin e gjyqtarit”, për sa i takon 3.B.a Shmangies së shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues. Pra propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 40.

Lidhur me “Paanësinë e gjyqtarit”, gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këtë arsye propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 10, lidhur me treguesin 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Sa i përket 3.C.b Numrit tejet të lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, rezultojnë të pakonsiderueshme, kështu që propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Lidhur me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale” propozohet të niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100 për gjyqtarin {...}.

Për sa i takon “Aftësisë personale dhe angazhimi profesional”, lidhur me 4.A Aftësitë e komunikimit, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të veçantë lidhur me këtë aspekt, kështu që propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë”, pikët 25.

Po ashtu respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale të palëve apo subjekteve të procedimit për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit, kështu që propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 15.

Për sa i takon “Aftësisë për të bashkëpunuar”, në të dy komponentët që vlerësojnë këtë tregues, paraqitet në nivel shumë të lartë gjyqtari dhe propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikëzimi përkatësisht 15 dhe 10 pikë.

Për sa i takon 4C. Gatishmërisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, rezulton referuar të dhënave se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese gjithsej 29 aktivitete të zhvilluara në 39 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë të përcaktuar nga ligji. Kështu që propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë lidhur me kriterin 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Për sa i takon 4.C.b Disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve, referuar të dhënave rezulton se ka kontribute gjyqtari lidhur me këtë tregues, ndaj propozohet vlerësimi me 5 pikë.

Po ashtu 4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata, rezulton se gjyqtari nuk provon të ketë dhënë kontribute të tilla. Kështu që niveli i vlerësimit lidhur me këtë tregues propozohet të jetë 3.

Gjithashtu edhe në lidhje me treguesin tjetër 4.C.ç Publikimet ligjore akademike, nuk rezulton që gjyqtari të ketë të tilla, nuk vlerësohet lidhur me këtë tregues.

Lidhur me “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” për gjyqtarin propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 93.

Kështu që propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtarin {...} propozohet si më poshtë:

“Aftësitë profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësitë organizative”, pikët 98, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 93, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 391.
Faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projekt-aktit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për periudhën 2020-2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare të datës 19.03.2024).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

9. Emona Muçi (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. {...}, Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 9. {...}, Inspektor magjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 10. Mimoza Koçiu, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 11. {...}, gjyqtar.*
- 12. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare të datës 19.03.2024).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, po vazhdojmë me pikën 4 që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesin e ILD-së dhe magjistratin {...}.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, dhe magjistrati z. {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

U paraqit zonja {...} dhe zoti {...}, me detyrë inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistratit zotit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. Autorizimi mban numrin {...}, datë 19 i vitit 2023. Gjithashtu është paraqitur edhe zoti {...}.

Në vijim të këtij procedimi disiplinor janë komunikuar z. {...} aktet të cilat ishin pjesë e dosjes së procedimit disiplinor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu edhe nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë paraqitur konkluzionet përfundimtare. Kështu që për vijimin e kësaj seance dëgjimore kërkoj qëndrimin e përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vijueshmërinë e kësaj seance dëgjimore, duke qenë se janë momentet që kanë paraqitur edhe konkluzionet përfundimtare. Ndërkohë që zotit {...} i janë paraqitur aktet e prezantuara nga ju dhe nuk ka paraqitur konkluzione përfundimtare.

Fjala për ju!

{...}: Në lidhje me konkluzionet përfundimtare në lidhje me seancën dëgjimore të zhvilluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ne konkluzionet përfundimtare i kemi paraqitur që në momentin e parë dhe i qëndrojmë kërkesave që ka paraqitur Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ato konkluzione.

Për sa i përket zhvillimit të seancës së kaluar gjyqësore ku u ngritën edhe

pretendime të ndryshme nga magjistrati, të cilat nuk janë paraqitur në ato konkluzione, unë në mënyrë të përmbledhur po i paraqes në këtë moment përpara Këshillit.

Seanca e kaluar dëgjimore e cila u zhvillua pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ana e magjistratit {...} u ngritën...

Ilir Rusi: Ju lutem, pa ju ndërhyrë.

Meqenëse ju i keni me shkrim, në mënyrë sintetike, të na paraqisni qëndrimin tuaj përfundimtar në lidhje me këtë procedim disiplinor.

{...}: Atëherë, në mënyrë të përmbledhur, u ngritën pretendime në lidhje me afatin e parashkrimit të disa të dënuarve për lirimin me kusht, siç ishte rasti i {...} dhe {...}, ku nga ana jonë konstatohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi referuar edhe dispozitave që ka vetë ligji 96/2016, i ndryshuar, të harmonizuara këto dispozita me njëra-tjetrën, duke filluar që nga neni 117, neni 124, 126 dhe neni 139 të këtij ligji, të harmonizuara me njëra-tjetrën, ato parashikojnë afatin e parashkrimit të shkeljeve disiplinore 5-vjecar, nga momenti i kryerjes së shkeljes disiplinore deri në momentin e fillimit të hetimit disiplinor. Kurse nga magjistrati u pretendua që afati i parashkrimit shkon deri në paraqitjen e kërkesës për procedim disiplinor para Këshillit.

Ndërkohë me rastin tjetër, kur shtyhet afati 1-vjecar, rezulton se edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi në rastin e të dënuarit {...} ku aplikohet afati 6-vjecar, pra me një shtyrje 1 vit, kjo vjen për shkak se vetë ligji parashikon për shkelje të të njëjtës natyrë, të ndodhur brenda periudhës së parashkrimit të shkeljes së mëparshme disiplinore të pretenduar, afati i parashkrimit shtyhet me një vit. Ky është rasti konkret i të dënuarit {...}.

Për sa i përket shkeljes së të njëjtës natyrë, pasi magjistrati pretendoi që nuk është i njëjti shkak në vendimet e tij për lirimin me kusht, edhe ky pretendim për ne nuk qëndron, pasi shkak nuk ka të bëjë me shkeljen e të njëjtës natyrë, por shkelje e të njëjtës natyrë është pikërisht shkelja disiplinore që parashikon ligji 96/2016, i ndryshuar, me të cilat në rastin konkret janë aplikuar magjistratit si përfitim i padrejtë i të liruave me kusht si dhe nga ana tjetër, shkelja e dytë, ajo e zbatimit të gabuar të ligjit material ose procedural penal.

Një pretendim tjetër që u ngrit nga ana e magjistratit ishte ajo e ankesës anonime, pra që lidhet me ankuesin {...}, ku në rastin konkret është e vërtetë që edhe në ILD është paraqitur një shkresë e këtij shtetasi, i cili i referohet vetes si {...} dhe si {...}, kështu që duke mos qenë dhe në kompetencën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, siç u pretendua, që të verifikohet që ankesa nuk është bërë nga ky shtetas, mund të jetë e falsifikuar; nga ana tjetër edhe një ankesë anonime është një indicie e mjaftueshme për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë që të vijojë ose të fillojë, në rastin konkret të vijojë edhe kryesisht hetimin disiplinor mbi faktet që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të përmendura në ankesën anonime, si në rastin konkret, domethënë që faktet e vëna në themel të ankesës së shtetasit {...}, kanë të bëjnë me një çështje konkrete të magjistratit, të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Pretendime të tjera, në mënyrë të përmbledhur, që u paraqitur para KLGJ-së, janë ato të cilat magjistrati iu referua raportit tematik që ka bërë ILD për lirimet me kusht, ku u pretendua konkretisht se edhe në këtë inspektim që ka bërë ILD-ja nuk janë gjetur shkelje në vendimet e tij të dhëna në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, në lidhje me kriterin e zbatimit 2/3 apo 3/4.

Gjithashtu në lidhje me arsyet e veçanta, apo në lidhje me plotësimin e kriterit objektiv të momentit të paraqitjes së kërkesës apo të dhënies së vendimit pra momenti deri në të cilin duhet të llogaritet kushti objektiv i plotësimit të dënimit të vuajtur nga i dënuari. Edhe këto pretendime, sipas nesh, nuk qëndrojnë sepse inspektimi tematik të cilit iu referua në shumicën e pretendimeve magjistrati, është bërë mbi bazë të vendimeve gjyqësore, pa administruar dosje, është bërë për një periudhë të gjatë trevjeçare, duke administruar vendimet gjyqësore për një periudhë trevjeçare të gjykatave të të gjithë rretheve gjyqësore. Nuk ka pasur të bëjë me konstatime individuale në raport, por me gjetje të përgjithshme të praktikës të ndjekur nga gjykatat shqiptare në lidhje me lirimet me kusht, përderisa në atë periudhë kanë qenë edhe problematike me disa lirime me ndikim pak në shoqëri, dhe kjo ka qenë tema e inspektimit tematik, pra për të konstatuar praktikën gjyqësore të gjykatave në lidhje me lirimin me kusht. Normalisht nëse konstatohen shkelje individuale, ato janë pjesë e verifikimit të veçantë, të cilat i ka aneksi i këtij inspektimi tematik, por që nuk janë në atë që është publikuar, pra në inspektimin tematik të publikuar, janë pjesë e aneksit të veçantë për të cilin kanë filluar (u tha edhe

në seancën e kaluar) verifikime individuale dhe kjo i referohet edhe rastit konkret për vendimet e magjistratit, ku edhe prokurori, meqenëse u pretendua, është pjesë e këtyre verifikimeve, prokurori që ka marrë pjesë në gjykimet e zhvilluara nga gjyqtari {...}.

Në mënyrë të përmbledhur këto ish-in parashtrimet tona, pra që i referohen vetëm seancës dëgjimore, pasi konkluzionet janë paraqitur, është shprehur mendimi ynë për pranimin e kërkesës së ILD-së dhe caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për shkeljet e konstatuara nga ILD.

Ilir Rusi: Faleminderit i nderuar!

Për më tej, fjala për zotin {...}.

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në seancën e mëparshme unë kam bërë një detajim të saktë dhe besoj të plotë të gjithë kundërshtimeve që unë kam pasur lidhur me materialin, procedurës që ka paraqitur Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në këtë seancë do të bëj një përmbledhje të shkurtër, por duke iu referuar, ashtu si edhe Inspektori, problematikave dhe debateve që lindën në seancën e kaluar.

Unë mendoj që afati procedural i parashkrimit të kërkesave, pra të procedimeve disiplinore, është momenti kur paraqitet kërkesa në KLGJ për procedim disiplinor. Çmoj se ky është momenti procedural që vendos Inspektori në lidhje me marrjen ose jo të iniciativës për masë disiplinore. Duke e vlerësuar si të tillë, vlerësoj se tre nga çështjet, ajo e {...}, ajo e {...} dhe çështja e {...} ndodhen tej afatit 5-vjeçar, bile ajo e {...} ndodhet tej afatit 5-vjeçar edhe në raport me marrjen e vendimit të Inspektorit për të kryer hetim, por në fakt Inspektori hetim kryen që në fillim, pra që me paraqitjen e një ankese, Inspektori fillon kryen hetim, pastaj pjesa procedurale se si ai ndërvepron (pra Inspektori i Lartë me inspektorët e tjerë) në marrjen e shpjegimeve ose mbledhjen e provave, janë procedurë administrative por që konkludohen me paraqitjen ose jo, në vlerësim të tyre, të kërkesës në KLGJ. Pra unë mendoj që paraqitja e kërkesës në KLGJ është edhe afati përfundimtar që duhet të merret në konsideratë në lidhje me parashkrimin e hetimit disiplinor. Kështu që, në këto kushte, unë i qëndroj kërkesës sime për parashkrim të procedurës disiplinore në lidhje me këto tre çështje.

Gjithsesi, për tej kësaj, unë do të jap shpjegime në mënyrë të përmbledhur për secilën prej tyre.

1) Inspektori në kërkesën që ka sjellë është shprehur që në mënyrë të padrejtë dhe jo në respektim të ligjit është vendosur lirimi para kohe me kusht për të dënuarin {...}. Pretendimi i Inspektorit në seancën e mëparshme ishte që një dënim i mëparshëm për një kundërvajtje penale, e cila nuk përbënte shkaqe personi i dënuar të quhej përsëritës, në analizë të provave bashkë me provat e tjera, duhet ta çonte gjykatën në bindjen që ky person duhet të përfitonte lirin me kusht. Atëherë, {...} ka qenë i dënuar për veprën penale “Dhuna në familje”, ka qenë i dënuar me 15 muaj burgim. Ka plotësuar të gjitha kriteret që parashikonte ligji. Ka qenë i burgosur në IEVP Tepelenë; gjykatë kompetente ka qenë Gjykata e Gjirokastrës; nuk ka paraqitur kërkesë brenda 6 muajve të rrëzuar nga gjykata, pra të mëparshme; nuk ka qenë përsëritës; ka plotësuar afatin kohor, në rastin konkret ka pasur një dënim të 2/3 të dënimit, pasi edhe vepra penale nuk parashikonte më shumë se 5 vjet (tek kjo pjesë do ndalem pak në vijim) dhe ka paraqitur certifikatën e gjendjes gjyqësore me shënimin “i padënuar në gjyq”. I gjithë gjykimi që është bërë, është bërë duke e konsideruar këtë të padënuar. Pra në certifikatën e gjendjes gjyqësore nuk kishte asnjë lloj shënimi, as për kundërvajtje penale, të cilat do më shtynte mua si gjyqtar i çështjes që ta merrja në konsideratë një histori të mëparshme të tij kriminale, qoftë kjo edhe kundërvajtje penale. Unë vlerësoj që nuk është në detyrën dhe misionin e gjykatës që të kryejë hetime, qoftë edhe në këtë pjesë, për aq kohë që asnjë nga palët nuk ngre një pretendim. Detyrën për të hetuar në lidhje me situatën e mëparshme kriminale ose jo të të dënuarit e ka prokurori që mbron interesat e shtetit dhe shoqërisë drejtpërdrejtë, edhe të ndjekjes penale. Unë si gjyqtar, për sa kohë nuk më ngrihet nga palët, nuk kam pse të vë në diskutim dhe të dyshoj që një dokument i lëshuar nga një institucion Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shënimin “i padënuar”, duhet që ta marrë me skepticizëm dhe më pas pastaj duhet të kryej hetim, se s’di ku ta kryej këtë hetim. Këtë hetim Inspektori e ka kryer më mbrapa, pasi ish-bashkëshortja ka bërë një ankesë dhe ka thënë pse është liruar një person i dënuar më parë dhe Inspektori mbi bazën e ankimit të saj dhe referimit ka kërkuar dhe ka marrë informacionin nga gjykata dhe nga prokuroria e Sarandës. Kështu që gjykimi ka filluar dhe ka mbaruar më faktin që ky person ka qenë i padënuar.

Edhe një diçka tjetër, nuk është diskutuar në seancën e mëparshme. Në relacion është ngritur pretendimi nga prokurori që dënimi i mëparshëm për kundërvajtje penale të “Mosdhënies së mjeteve për jetesë”, është amnistuar dhe prandaj nuk është shënuar. -Jo! Amnistohet ekzekutimi i ndjekjes penale, ekzekutimi i vendimit penal, por jo dënimi penal dhe fakti që nuk është shënuar dënimi penal, është përgjegjësi e gjykatës që mundet të mos ta ketë përcjellë apo e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që nuk e ka ekzekutuar. Amnistia shuan, siç ne e dimë të gjithë, ekzekutimin e dënimit penal, por jo dënimin penal. Kështu që mosfunksionimi i institucioneve të tjera që kishin detyrimin për ta pasqyruar në certifikatën e gjendjes gjyqësore, nuk mund të më atribuohet mua që pse unë e gjeta, nuk e parashikova, sepse nuk kisha asnjë lloj mundësie për sa kohë që nuk u ngrit. Në rast se do të ishte diskutuar, nëse ky fakt do të ishte relatuar pastaj, sigurisht që është do të kisha një vlerësim, nuk mund të them që mund të kisha një vlerësim ndryshe, sepse vlerësimi është i asaj kohe, janë shumë rrethana që ndikojnë; gjykimi është një gjë e gjallë, nuk është një gjë që bëhet mbi bazën e letrave; mund të kisha edhe një vendim rrëzimi, por është një diçka që nuk është marrë në konsideratë. Pra unë kam vlerësuar që ky persona ka qenë i padënuar më parë sepse mua kështu më ka ardhur.

Gjithsesi është vetë Inspektori që thotë që edhe në rast se ky dënim do ishte marrë në konsideratë, përsëritës nuk konsiderohen personat që janë dënuar më parë për kundërvajtje penale, pra përsëri do të konsiderohet i padënuar.

Inspektori hyn tek pjesa që thotë që ky dënim penal i paverifikuar, nëse do të verifikohej me provat e tjera, nuk do çonte në lirimin e këtij personi. Tani kjo është ajo pjesa subjektive në procesin për lirimin me kusht. Unë edhe në seancën e mëparshme iu referova raportit të inspektimit tematik ku Inspektori ka marrë dhe ka detajuar, analizuar, verifikuar, detajuar, rekomanduar në lidhje me të gjithë pjesën objektive, atë që unë përmenda pak më para.

Kurse në lidhje me pjesën subjektive, vlerësimi i provave dhe bindja e brendshme e gjyqtarit, kjo është një diçka që Inspektori nuk i hyn dot. Në qoftë se do t'i hyjë edhe kësaj pastaj i bie që praktikën gjyqësore do ta vendosi Inspektori dhe nuk mund ta vendosi gjykata.

E kam referuar edhe herën e mëparshme, po e referoj edhe tani që është vetë Inspektori që në shumë e shumë vendime të tjera arkivimi, midis të tjerave edhe disa

që janë në raport me personin tim, është shprehur, për shembull tek vendimi 119/1 i datës 17.17.2022 shprehet: Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor. Pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar apo prishur nga një gjykatë më e lartë. Ky në fakt është citim nga Gjykata Kushtetuese. Pra të marrësh sot në analizë dhe të thuash që në bazë të këtyre provave gjykata duhet të kishte vendosur ndryshe, këtu hyn tek analiza e provave, tek bindja e brendshme e gjyqtarit që nuk është në vlerësimin tim kompetencë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Realiteti është që përtej kësaj, nuk u diskutua, pra deri sa është shpallur vendimi gjyqësor, nuk është diskutuar fare nëse do të ekzistonte, nëse ekzistonte një vendim i mëparshëm dënimi penal, qoftë edhe kundërvajtje penale, që nuk e konsideronte përsëritës. Të gjitha palët kanë qenë për pranimin e kërkesës, që nga IEVP-ja, që nga shërbimi i provës, që nga prokurori dhe gjykata ka vendosur, vendimi ka marrë formë të prerë, pra nuk është konstatuar vlerësim i gabuar i provave apo realizimi i bindjes jo të saktë të gjyqtarit mbi bazën e provave nga një gjykatë më e lartë. Kështu që unë konstatoj që ky vendim nuk ka asnjë shkelje. 3 muaj e 18 ditë që këtij personi i është dhënë dora nga gjykata për të vajtur pranë familjes për të ushqyer dy palë fëmijë, sepse edhe dhuna në familje ka qenë në lidhje me kërkimin e llogarisë së fëmijëve të mëparshëm që jetonin me ish-bashkëshorten, që pse ky nuk kujdesej për familjen e mëparshme, por kujdesej për familjen e re. Ka pasur nevoja familjare. Vajzën tjetër e kishte në shkollë. Ishte i vetmi person që kontribuonte në shtëpi. Dhe unë në vlerësim të të gjitha këtyre kam vlerësuar që 3 muaj e 18, që këtij personi nëpërmjet dënimit të vuajtur ishte realizuar rehabilitimi i këtij personi, dhe nuk ishte e nevojshme që ky person të mbahej në vijim për këtë periudhë shumë të shkurtër kohore në burg.

Në lidhje me “lirimin me kusht” të {...}, edhe për këtë Inspektori ka thënë që është vendosur në mënyrë të padrejtë lirimi me kusht. Në muajin shkurt ky person ka paraqitur një kërkesë ‘për lirimin me kusht’. Ka hequr dorë dhe është vendosur “pushimi” mbi bazën e një kërkesë, është vendosur “pushimi i çështjes”. Në vijim ka paraqitur dy

kërkesa, ka paraqitur një kërkesë “për ulje dënimi”, ka paraqitur edhe një kërkesë “për lirimin me kusht”. E gjithë dinamika e ngjarjes dhe interpretimi i prokurorit është që kërkesa “për uljen e dënimit” është shqyrtuar shpejt, është shqyrtuar më para në kohë që i dënuari të plotësonte afatin për të përfutur, për të plotësuar 3/4 e pjesës së vuajtjes së dënimit. Por më pas edhe vetë e konstaton që për një gabim timin, por që mua më vlejti këtu për të kundërshtuar, pra më doli për mirë ajo pjesë, unë kur kam dhënë vendimin “për lirimin me kusht” nuk e kam aplikuar 90-ditëshin që ishte dhënë ulje dënimi, pra nuk ka qenë e nevojshme sepse në rast se unë do ta kisha bërë enkas, me qëllim, pra që doja të ndihmoja një person që s’më ka shkuar kurrë ndonjëherë në mend të ndihmoj dikë në kundërshtim me ligjin, ky nuk është aplikuar. Kërkesa është paraqitur në muajin gusht. Është shortuar në datën 13 shtator, që ka qenë data e parë e shortimit pas pushimeve të verës. Është kryer brenda 10 ditëve procesi, e kam respektuar në të gjitha rastet këtë afatin 15-ditor të seancës së parë në penale. Kam paraqitur përpara jush të gjitha, edhe 20 e ca vendime të tjera, të cilat janë shqyrtuar vetëm në një seancë kërkesat ‘për ulje dënimi’, të bëra brenda 1 muaji, bërë pra nga 10 deri në 20 ditë, domethënë kur nuk i kam rrezuar për shkaqe ligjore, kam pranuar gjithmonë atë maksimumin që parashikon ligji 90 ditë, siç ka qenë edhe rasti konkret (jo i ndryshëm nga të tjerët) kur IEVP-ja në raportin që ka përpiluar për efekt të kërkesës ‘për ulje dënimi’, ka kërkuar “pranimin e plotë”. Gjersa është pranuar “pranimi i plotë”, sjellja ka qenë pozitive dhe unë kam vendosur “pranimin e plotë të tij”. Por që nuk ka pasur asnjë lloj tendence sepse ka rezultuar që tek lirimi me kusht këtë 90-ditsh që duhej të aplikohet, nuk është aplikuar, çka tregon që nuk ka pasur tendencë që fillimisht të kryhej dhe nëpërmjet këtij 90-ditshi personi të plotësonte, sepse realisht personi në momentin e shpalljes së vendimit “për lirimin me kusht”, ka plotësuar 3/4 e uljes së dënimit.

Një pyetje që më është bërë nga anëtarja e KLGJ-së në lidhje me praktikën time të mëparshme, ka qenë që, më ndihmoi edhe Inspektori herën e kaluar (si duket kishte pasur vëmendje më të duhur se unë që të vija i përgatitur), unë kam aplikuar 3/4 e dënimit mbi masën që parashikon në dispozita dhe jo mbi atë. Kështu që edhe ai diskutimi i herës së kaluar del që ka qenë i panevojshëm. Këtë e kam aplikuar në të gjitha vendimet dhe shihet sepse tek pjesa që unë ngre çështjet, atje kam gjithmonë atë 3/4 e masës së dënimit që parashikon dispozita penale që është dënuar personi.

Në lidhje me kërkesën “për lirimin me kusht” të {...}, ka rezultuar që ka bërë një kërkesë. Ka qenë kompetente gjykata. Kërkesë të mëparshme të rrëzuar nga gjykata nuk kishte, pra ka qenë kërkesë e pushuar, jo kërkesë e rrëzuar, që të kishte ndalim ligjor. Ka pasur një dënim të mëparshëm për të cilin ishte i rehabilituar. Këtu edhe inspektorët janë dakord edhe në raport që thonë që procesi i rehabilitimit e zhvesh personin nga pasojat e një dënimi të mëparshëm penal dhe nuk konsiderohet përsëritës. Shërbimi i provës ka qenë pozitiv. Nëse do më duhej të lexoj një pjesë të saj. (më fal). IEVP-ja ka qenë pozitive në pjesën që është shprehur por ka vendosur shenjën “por” dhe është shprehur që ka pasur një (nëse më duhet ta lexoj), atëherë: Vlerësim, sjellja në gjykatë objekt “lirimi me kusht” ka qenë IEVP-ja. Komisioni i IEVP-së i përbërë nga 5 anëtarë, ku kryetar është përgjegjësi i sektorit ligjor [...]. Atëherë, komisioni i vlerësimit shprehet se për të dënuarin {...} karakterizohet nga personaliteti pozitiv dhe social; shprehet, i motivuar dhe bashkëpunues për arritjen e objektivave të trajtimit; shpreh, motivimin për programet e punësimit; mundohet të ketë aftësi menaxhuese të riskut të vetë; bazuar edhe në dosjen psiko-sociale, i dënuari ka pasur sjellje dhe qëndrim korrekt. – Kjo është në raport me sjelljen. Por thonë: ...por Komisioni për sa më sipër shprehet për “rrëzimin e kërkesës” për arsye se i dënuari është përsëritës.

Pra IEVP-ja e konsideronte përsëritës për shkak se procesin e rehabilitimit nuk e njihnte si të tillë. Është diskutuar në seancë dhe unë e kam pyetur. Komisioni i këtij grupi që e ka realizuar këtë vlerësim, ka qenë edhe përfaqësuesi i IEVP-së në sallë, unë e kam pyetur dhe i kam thënë: Qëndrimi juaj për “rrëzimin e kërkesës” ka lidhje vetëm me faktin që personi është përsëritës apo edhe me ndonjë qëndrim të mëparshëm që mund të ketë për efekt të sjelljes?

Jo, - tha ai, - e kemi vetëm se është përsëritës, por këtë e vlerëson gjykata.

Dhe shërbimi i provës ka pasur vlerësimin e tij, në të cilën është shprehur që... Më falni për momentin se s’po e gjej dot.

Shërbimi i provës është shprehur: Duke analizuar, shqyrtuar dhe vlerësuar në përgjithësi e veçanti të gjitha sjelljet dhe qëndrimin aktual të dënuarit, vlerësojmë se nëse i dënuari plotëson kriteret formale të kërkuara nga neni 64 i K.Penal “për lirimin me kusht” dhe neni 477, si dhe mbështetur në kushtet e rekomandimit të vendimit të Gjykatës së Lartë ‘për institutin e lirimit me kusht’, i cili ka karakter riedukues human

dhe social, shërbimi i provës për të dënuarin {...} e lë në çmim të gjykatës për pranimin e kërkesës për lirim me kusht, pasi mundësia për t'u integruar në familje dhe shoqëri është një mundësi normale e vështirë por edhe e mundshme për t'i dhënë të dënuarit në bazë të ligjit edhe një mundësi edukimi dhe integrimi në familje dhe në shoqëri.

Përballë këtyre dy vlerësimeve që kanë bërë këto dy institucione, i dënuari ka pasur një moshë diku tek 21 vjeç, pra ka qenë i ri. Ka paraqitur edhe disa prova të tjera, që ky jetonte në një familje, babai i kishte vdekur më parë. Nëna, ka sjellë prova që trajtohej me kimioterapi për shkak të një sëmundje të rëndë tumorale dhe vëllai që kishte në shtëpi ishte invalid, pasi kishte lindur me mungesë të një gjymtyre (të një dore) dhe ky ishte i vetmi person që punonte, realizonte të ardhura në shtëpi.

Qëndrimi i prokurorit konkretisht në këtë çështje është: Nuk ekzistojnë shkaqe negative. Nuk rezulton një periudhë sigurie e vendosur nga gjykata. Nuk rezulton paraqitje e një kërkesë të rrëzuar brenda 6 muajve. Plotësohet periudha e dënimit e kryer. Lidhur me rehabilitimin - është fakt që është institut që e zhbën dënimin, në kuptimin që personi quhet i padënuar, nuk quhet përsëritës me dashje. Lidhur me mundësinë e integritit – të gjithë treguesit dhe sjellja e tij në IEVP si dhe treguesit e tjerë, predispozitat pozitive që ka pasur personi do t'i shpalosi në botën e jashtme dhe me ndihmën e faktorëve të tjerë që personi të integrohet plotësisht. Në këto kushte shprehemi “për pranimin e kërkesës për lirim me kusht”. Ky është konkluzioni që ka dhënë në fund prokurori.

Në lidhje me pjesën e masës së vuajtjes së dënimit, personi ka qenë i dënuar për veprën penale “për shitjen e narkotikëve” që parashikonte një dënim nga 7-15 vjet. Ishte dënuar me 5 vite burgim dhe unë kam aplikuar 3/4 e vuajtjes së dënimit, 3/4 e masës që ligji parashikonte, dispozitës, se u ngatërrova, pra 3/4 që parashikonte dispozita, për të cilën dhe ishte dënuar personi. Pavarësisht se në seancën e mëparshme kam arsyetuar, ka dhe vendime të Gjykatës së Lartë, referuar edhe raportit tematik, që një praktikë shumë e gjerë e gjykatës, e shumë gjykatave dhe gjyqtarëve është që e aplikojnë mbi masën e dënimit që ka dhënë gjykata. Pra nëse e ka dhënë deri në 5 vjet është 2/3 dhe mbi 5 vjet është 3/4. Edhe në raportin tematik që ka kryer Inspektori është që kjo çështje duhet ndarë nga Gjykata e Lartë sepse edhe Gjykata e Lartë ka qëndrime të ndryshme. Ka vendim që thotë mbi masën e dënimit që ka dhënë gjykata, pra deri në 5 vjet, 2/3, ka

edhe vendim që thotë jo, duhet mbi masën e dënimit që ka parashikuar dispozita penale që është dënuar personi.

Kështu që unë mendoj që i dënuari {...} ka plotësuar të gjitha kriteret që ka pasur ligji. Vlerësimet i kam quajtur pozitive. Nuk kam gjetur ndonjë shkak negativ të parashikuar në ligj. Shkaqet familjare kanë qenë për mua të jashtëzakonshme. Pra ndodhur në ato kushte që familja e tij, e sëmurë, me njerëz invalidë e me persona të vdekur; ky ishte i vetmi person; mosha e re; dënimi i mëparshëm “i rehabilituar” ishte për vjedhje në kohën kur ky kishte qenë i mitur; unë mendoj që në këtë rast kjo politika penale duhet të ishte lehtësuese dhe këtij personi duhet t’i jepej mundësia për t’u integruar në shoqëri dhe me atë kushtin që për atë periudhën që është pezulluar dënimi, të mos kryente edhe ndonjë vepër tjetër penale. Vendimi ka marrë formë të prerë. Nuk është ankimuar nga asnjë nga palët. Palët kanë qenë dakord. IEVP-ja ka pasur vetëm problemin që ishte ose jo përsëritës. Por që mendoj që këtu plotësoheshin të gjitha kriteret që ky person të fitonte “lirimin me kusht”. Asnjë lloj tolerance ndaj këtij personi s’kishte dhe aq më tepër që unë atë 90-ditshin ulje këtij nuk ia kam aplikuar tek ajo ulja, domethënë i është falur një vit dhe duhet t’i ishin falur 8 muaj sepse ai tremuajshi që unë sapo e kisha kryer, nuk e kam aplikuar. Që është një gabimi im, por ky është një gabim që s’e ka pretenduar asnjë nga palët. Mund të korrigjohej, mund të rregullohej, mund të plotësohej. Por që ky është një gabim që nuk ka lidhje, se iu referuar pak a shumë Inspektori në seancën e mëparshme, nuk ka lidhje me lirimin me pa të drejtë të {...}. Unë këtu kam ardhur sepse pretendohet se kam liruar në mënyrë të padrejtë {...}, dhe ky është një gabim që ndodh në punën tonë të përditshme. Unë kam punuar edhe falë vendimmarrjes tuaj për disa muaj në Gjykatën e Apelit. Nuk ka vendim gjykata e shkallës së parë që po të duash të gjesh ndonjë gabim, aq më tepër gabime materiale, siç ka gjetur Inspektori, nuk e gjen. Kjo vjen për shkak të ngarkesës në punë apo edhe për shkak ndonjëherë të aftësive apo mundësisë për të korrigjuar një vendim që ke shkruar vetë.

U pretendua herën e parë që u konstatua një gabim material, sepse në të gjitha vendimet unë i kam të gjitha njësoj, sepse një format mbajmë, nuk mund të bëjmë dot formate të ndryshme për çdo lloj gjykimi, dhe në vendim unë shkruaj që në interpretim të dispozitave të mësipërme (pasi kam hedhur dispozitat) them që duhet të plotësohen nga kërkuesi kumulativisht këto kushte: Të ketë kryer jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë –

rasti i {...}. Por kur dalë dhe pasi bëj llogaritjen, dal në konkluzionin dhe them: “...në këto kushte kërkuesi plotëson kriterin e vuajtjes së 2/3 e dënimit”. Ky është një gabim material që s’ka asnjë lloj vlere sepse unë e kam thënë lart që është aplikuar 3/4. Po të ishte se unë do ecja me shkakun që nëse plotësonte 2/3, ky do ta plotësonte të paktën një 5 muaj përpara këtë 2/3 dhe i binte që mos të hiqte dorë as nga ajo kërkesa “për lirimin me kusht” e paraqitur më herët sepse i binte një diferencë diku tek 7-8 ditë. Pra ka plotësuar 3/4 e dënimit dhe ky gabim në fakt që është një gabim material, po ta shikosh është tek të tria vendimet. Unë nuk e kisha vënë re më parë. E pashë. Edhe tek {...} edhe tek {...}, edhe tek {...} është i njëjti gabim, se si duket nga ngarkesa, nga shpejtësia, këto pjesët e vendimit që janë të përgjithshme, ndonjëherë ne gabojmë dhe nuk i korrigjojmë në varësi të çështjes. Por që këto janë gabime që kurrsesi s’kanë lidhje me themelin e çështjes, as me thelbin, as me shkaqet për të cilat është liruar me kusht ky person. Ky vendim ka marrë formë të prerë. Vlerësimi i provave mendoj se është bërë në mënyrë objektive. Dakord ka qenë prokurori, dakord kanë qenë të gjitha palët. Sjelljen e ka pasur pozitive. Unë vlerësoj se kam dhënë një vendim të drejtë pa paragjykime dhe pa cenuar as nenit 477 të Kodit të Procedurës Penale as nenin 64 të Kodit Penal.

Në lidhje me “lirimin me kusht” të {...}, është bërë një përlllogaritje nga Inspektori dhe thuhet që gjykata i ka ulur 4 muaj ndërkohë që ai i kishte ngelur pa kryer 7 muaj. Por më pas, vetë Inspektori e ka konstatuar që e ka thënë që gjatë gjykimit është administruar edhe një vendim penal i një trupi tjetër gjykues që i kishte ulur tre muaj, pra 90 ditë, dhe unë kam aplikuar pikërisht këtë në rastin konkret, para se unë të shpallja vendimin, pra gjatë kryerjes së gjykimit për lirimin me kusht, kërkuesi ka paraqitur një vendim penal që për 1 vit dënim të kryer më parë, i ishte ulur 90 ditë, dhe unë e kam aplikuar; dhe nga 7 muaj që ishte raporti i IEVP-së që ky kishte pa vuajtur, i ngeleshin që kishte 4 muaj. Dhe këto 4 muaj i kam... Domethënë këto 4 muaj i kemi pezulluar.

Në lidhje me arsyetimin e vendimit – Janë aq “copy-paste” këto vendimet e mia sa edhe gabimet ortografike janë “copy-paste”, sa nuk mundet që disa vendime të jenë të arsyetuara dhe ky është më pak i arsyetuar, -siç pretendon Inspektori. Përtej asaj që unë i qëndroj që interpretimi i vendimit nuk mund të konstatohet nga... më falni, “arsyetimi i vendimit është “copy-paste” me arsyetimet e tjera”, nuk mund të konstatohet nga Inspektori, duhet të konstatohet nga një gjykatë më e lartë. Dhe ky vendim ka marrë

formë të prerë. Unë nuk e shoh ku ka ndonjë gabim dhe e kam liruar në kundërshtim me ligjin këtë {...}n? Jo! Por edhe Inspektori nuk e ka ngritur këtë pretendim. Se përse e ka sjellë si shkelje timen {...}n unë nuk e kuptoj?! S'ka asnjë lloj shkelje. Pra nga 7 muaj në 4 muaj. Edhe vetë Inspektori e ka përllogaritur që është administruar edhe një vendim me ulje dënimi në 90 ditë.

Në lidhje me “lirimin me kusht” të {...} unë kam vendosur “rrezimin e kërkesës” ky person për mungesë paraqitjeje të provave. Çështja është ankimuar dhe ka vajtur në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit në një rresht shprehet që gjykata e ka interpretuar gabim, ka bërë shkelje procedurale të nenit 477, por e lë me kaq. Dhe tek raporti tematik kjo çështje është cekur nga inspektorët dhe konkretisht në raportin tematik inspektorët kanë thënë: “Gjykata e apelit mbi bazën e një ankimi ka vlerësuar të procedojë me hetim të pjesshëm në drejtim të administrimit të vërtetimit të gjykatës së rrethit gjyqësor me kërkesën e mëparshme të kërkuarit nga i cili rezultoi se nuk kishte të tilla. Në vazhdim gjykata, pas prezantimit të këtij fakti, ka konkluduar se arsyetimi sa më sipër i gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparaqitjen e një prove nga kërkuari për kërkesën e mëposhtme vjen në kundërshtim dhe keqinterpretim të kërkesave procedurale që kërkon neni 477 i K.Pr.Penale.” Ky është motamo siç është shprehur inspektori në raportin tematik. “Ky konkludim nuk është shoqëruar me ndonjë arsyetim konkret dhe gjykata e apelit më tej ka vazhduar me arsyetimin e plotësisht të kërkesave të tjera lidhur me kriteret objektive dhe subjektive.” Pra ashtu siç duket, edhe po të lexosh vendimin e gjykatës së apelit dhe po të shohësh edhe siç e kanë konstatuar, gjykata e apelit ka thënë që është keqinterpretuar neni 477, po se ku është keqinterpretuar dhe pse është keqinterpretuar ky nen, nuk e ka shprehur. Po t’i referohesh procesverbalit të seancës në gjykatën e apelit, konstatojmë që provën e munguar të paraqitur në shkallën e parë, gjykata e apelit ia ka kërkuar avokatit, pra ka riçelur hetimin gjyqësor; ia ka kërkuar avokatit; i ka dhënë kohën e nevojshme; e ka marrë, e ka administruar; ka plotësuar procesin provues që është detyrimi i palës dhe i gjykatës dhe pastaj ka ndryshuar vendimin tim, pra nuk e ka prishur, ka ndryshuar vendimin tim dhe ka vendosur “pranimin e kërkesës”. Pra jemi para faktit të administrimit të provave të reja nga gjykata e apelit. Administrimi i provave të reja nuk ka lidhje me shkelje procedurale. Shkeljet procedurale e çojnë në tjetër pasojë, e çojnë në prishjen e vendimit dhe kthimin për

rigjykim, kur janë cenuar ose rregulluar nga gjykata e apelit, nëse ato nuk janë të tilla që kanë cenuar të drejtat dhe interesat e palëve në proces.

Tani, unë jam i mendimit që jo gjithçka që shkruhet në vendimin e apelit ne duhet ta marrim me apriori, sidomos kur janë të pabazuara, të paarsyetura, siç është rasti konkret. Këtu nuk ka asnjë shkelje procedurale. Unë i kam kërkuar palës të paraqiste provë, që nuk kishte kryer gjykime të tjera të mëparshme, kërkesa të tjera në gjykatë. Nuk e ka paraqitur. Në mungesë të provueshmërisë së provave formale, ia kam rrëzuar kërkesën. Çështja ka vajtur në apel. Atë që nuk është paraqitur dhe nuk donte avokati ta sillte në shkallë të parë, e ka çuar në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit e ka marrë dhe e ka vlerësuar në raport me provat e tjera dhe ka vlerësuar provueshmërinë e fakteve mbi bazën e provave të paraqitura. Nuk po i nisem pastaj që të rri, duhej gjykata e apelit të merrte prova të reja; s' duhet të merrte prova të reja; por ajo që është e rëndësishme është fakti që shkeljet procedurale nuk kanë lidhje me procesin e provueshmërisë së faktit, pra sasisë dhe provave që paraqesin palët. Kështu që unë mendoj që nuk kam kryer në rastin konkret asnjë shkelje procedurale. Kam zbatuar realisht ligjin. Gjykata e apelit për mua në këtë rast lë shumë për të dëshiruar në arsyetimin e vendimit, qoftë për sa i përket arsyetimit të vendimit, qoftë për sa i përket edhe mënyrën se si shprehet e cenon vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur pa dashur ose ndonjëherë edhe para faktit që gjyqtari i shkallës së parë ka gabuar. Nuk janë treguar të kujdesshëm. Kanë shkruar diçka në vendim që nuk qëndron mbi bazën e të gjithë procesit që ata kanë kryer. Kanë marrë prova të reja. Ka qenë procesi provues. Nuk janë shkelje procedurale. Nuk është se u paraqit provë dhe unë nuk e pranova këtë provë. Kjo provë nuk është paraqitur fare në shkallë të parë dhe për mungesë të paraqitjes së provës është rrëzuar kërkesa. Kështu që kjo është e gjithë pjesa.

Edhe në seancën e mëparshme unë kam arsyetuar edhe në lidhje me (t'i kthehem pak {...}), ka pasur një masë disiplinore në burg por që ishte parashkruar dhe me kalimin e dy viteve konsiderohet e pa dhënë. Edhe në rastin e disa vendimeve shtesë që unë kam sjellë, por që kanë qenë objekt inspektimi nga inspektori, kam analizuar edhe gjerë e gjatë për rastet e dënimeve disiplinore gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, afatin e parashkrimit të tyre, parashikimin ligjor kur ato konsiderohen të pa dhëna dhe kur s'konsiderohen të tilla nuk mund të merren. Kam marrë në konsideratë dhe kam respektuar gjithmonë

vendimmarrjet për sa kohë nuk kam pasur pretendime të kundërta me vendimmarrjet dhe mendimin që ka dhënë shërbimi i provës, sidomos grupi i I EVP-së Tepelenë. Aty ku më është dashur të respektoj politikat penale, i kam respektuar. Në vendimet që kam sjellë ka pasur raste të rrëzimit të kërkesave “për lirimin me kusht” për vepra penale që kanë qenë të rënda apo për persona që paraqisnin rrezikshmëri. Aty ku vërtetë nuk ka qenë e nevojshme që personi të vazhdonte me vuajtjen e mëtejshme të dënimit për shkak të shumë rrethanave që vinin, sidomos që kanë të bëjnë me mënyrën e vuajtjes së dënimit me pjesën rehabilituese të tij, duke marrë në konsideratë edhe rrethanat familjare, kam menduar që për këta persona, vijimi i mëtejshëm i dënimit penal ka qenë i panevojshëm.

Unë mendoj se realisht nuk kam kryer asnjë shkelje. Nuk e di, e thashë edhe herën e parë dhe duhet t’i kthehem pak asaj pjesës tek rasti i {...}, pasi e kam kërkuar për dy vite, vetëm fal jush mua më është vënë në dispozicion ankimi i {...}. Inspektori thotë që ai nuk e di emrin e tij, por ai e di shumë mirë sepse aty kur e ka nënshkruar me dorën e tij, e ka vënë {...}. Po çfarë rëndësie ka {...} apo {...}?! Është i njëjti person. Ajo nuk është një ankesë. Unë e kam këtu, e lexova. Kjo është “copy-paste” e një shkrese po tjetër që është e tillë, që i drejtohet Komisionerit Publik, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Unë nuk e lexoj dot sepse më vjen ndot nga vetja ta lexoj këtë. Fyerje, shpifje, ofendime. Vetëm fjalinë e fundit po them: “Verifikoni aktivitetin e këtij gjyqtari përbindësh.”. Lëri të tjerat lart: “kriminel, i dënuar”. Nuk e di! Të tëra të këqijat i paskam pasur unë. Fatmirësisht unë e kam gjetur kush e ka bërë këtë, këtë edhe atë tjetrën, dhe sot janë në procedim penal. Fatkeqësisht është kolegja ime. Çuditërisht! Por kjo është një diçka tjetër. Unë ia kam përcjellë Inspektorit. Dhe {...} i ka çuar një shkresë, që nuk jam unë ankuesi. Unë nuk e di! Megjithatë Inspektori le të bëjë punën e vet. Unë jam i hapur jo të hetoj këtë, por çfarë të dojë. Këtu është hetuar edhe shorti, mënyra e hedhjes së çështjeve në short, meqenëse unë kam qenë drejtuesi i gjykatës në atë periudhë. Janë inspektuar të gjitha çështjet. Sa herë që ka një ankesë ndaj meje, mua më inspektohen të gjitha, domethënë gjithë puna. Në qoftë se ka, kishte një ankesë për një masë sigurimi, më janë inspektuar të gjitha masat e sigurimit, që nga 2015 që kam filluar punë. Kishte një ankesë për sigurimet e padisë, më janë inspektuar të gjitha sigurimet e padisë. Realisht nuk ka pasur asnjë shkelje, asnjë. Më bën çudi pastaj, siç është edhe rasti konkret që ndodhemi këtu që

mbi bazën e një shkrese shumë fyese, shumë ofenduese, të arrihet që të fillohet një procedim disiplinor ose hetim. Ju e patë, siç unë e relatova, nuk ka asnjë lloj shkelje, as të nenit 477, ashtu edhe të nenit 64. Nuk kam liruar asnjë të dënuar për të cilin ligji ka pasur një parashikim ndalues. Pra një nga veprat penale që ndalohet shprehimisht “lirimi me kusht”, asnjë nga personat nuk ka qenë përsëritës, në kuptim të ligjit. Si gjykatë kam qenë gjithmonë gjykatë kompetence. Të gjithë nuk kishin bërë kërkesa të mëparshme. Vlerësimet e të gjithëve kanë qenë pozitive të IEVP-së, të Shërbimit të Provës, të prokurorit, të gjithë kanë qenë dakord, asnjëherë kundër. Aty ku ka qenë kundër, me prokurorin pothuajse kemi pasur të njëjtin mendim dhe e kemi reflektuar edhe në vendimmarrjet tek çështjet e tjera që kam sjellë por që nuk i referohet Inspektori, por të gjitha këto që ka sjellë si shkelje të miat, të gjitha palët kanë qenë dakord. Vendimet janë të paankimuara. Vendimet kanë marrë formë të prerë. Inspektori thotë në vendimet e arkivimit që vendimet e formës së prerë, vlerësimi i provave, bindja e brendshme e gjykatës nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga asnjë organ tjetër, duke përfshirë edhe Inspektorin. Në rastin konkret ka vlerësuar ndryshe dhe sot ndodhemi përpara jush.

Në konkluzion, unë kërkoj vetëm drejtësi. Kam punuar me shumë përkushtim si gjithë kolegët e mi, nuk jam unë i vetmi, për një periudhë të gjatë, me një ngarkesë të jashtëzakonshme në punë. Kemi edhe ndonjë gabim në material, por nuk kam shkelur kurrë ligjin, me dashje jo e jo, por as nga pakujdesia, dhe nuk kam bërë kurrë një interpretim të gabuar të ligjit për asnjë lloj arsye. Në rastin konkret, vendimet tregojnë një gjë të tillë. Pra në të gjithë dinamikën e dhënies së vendimeve të mia, janë sjellë këto vendime të cilat edhe vetë duken që nuk asnjë lloj gabimi. Tani të tjerat i bie që kanë qenë më të mira, kanë qenë shembull. Këto janë më problematiket. Se ku është problemi këtu, unë nuk e gjeta dot.

Kështu që, në përfundim, unë kërkoj që të rrëzohet kërkesa, duke falënderuar për vëmendjen, të rrëzohet kërkesa e Inspektorit për caktim mase disiplinore ndaj meje. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}.

(Zoti {...} parashton pa ndezur mikrofonin lidhur me parashtrimet të cilat i ka me shkrim.)

Ilir Rusi: Ju lutem, depozitohuni!

Përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. {...}, të largohen, me qëllim që të vijojë Këshilli me diskutimet.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, si dhe magjistrati z. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë në vijim të diskutimeve, zoti Kurushi ka diçka për të thënë.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, në vijim të diskutimit të çështjes së ngritur nga ILD-ja, ndaj magjistratit {...}, meqenëse edhe konkluzionet përfundimtare u mbyllën ditën e sotme dhe meqenëse zoti {...} sot ka paraqitur me shkrim konkluzionet përpara mbledhjes, unë do propozoja që këto konkluzione të na viheshin paraprakisht nga një kopje secilit prej anëtarëve që të njëjët më hollësisht me përmbajtjen e tyre, si dhe më pas të verifikojmë përmbajtjen e tyre me të gjithë materialin tjetër që na është vënë përpara dhe është shqyrtuar në dy seanca nga mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Domethënë, për këto arsye, njihjen më në detaje të konkluzioneve që i paraqiti sot kandidati, si dhe të konfirmimit/të verifikimit të këtyre konkluzioneve me materialet e tjera, unë do propozoja që seancën e shpalljes së vendimit (pasi jemi në shpallje të vendimit), ta caktojmë për një datë tjetër. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime?

Kur mendoni se mund të jetë data më e arsyeshme zoti Kurushi?

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Unë propozoj datën 18, nëse kolegët janë dakord, pra javës tjetër, ditën e enjte.
Nëse kolegët janë dakord me këtë afat që unë po propozoj.

Pastaj për orën e diskutojmë. Ora 11:00?

Datë 18, ora 11:00 propozoj.

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e propozimit të zotit Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ftoj administratën të njoftojë palët.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, si dhe magjistrati z. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të këtij procedimi disiplinor, pas paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nga magjistrati zoti {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendimin e tij në lidhje me këtë procedim disiplinor do ta shpallë më datë 18 prill, ditë e enjte, ora 11:00. Faleminderit!

18 prill, ditë e enjte, ora 11:00, do bëjë shpalljen e vendimit.

(Dalin palët nga salla e mbledhjes.)

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Ridvan Hado.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj pike z. Markelian Koça.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.**
6. **Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.**
7. **Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Ridvan Hado.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, vazhdojmë me pikën 6 të këtij rendi dite, ku zoti Koça nuk do të marrë pjesë në shqyrtim, diskutimin dhe votimin e kësaj pike. Ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Më vendimet nr. nr. 245, datë 24.05.2023, 2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit ka kandiduar edhe z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Aktualisht gjyqtari është transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 57 të Këshillit është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nga shorti jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Në vijim, më datë 25.03.2024, kandidati z. {...} ka parashtruar kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Mbledhjen e datës 27.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, vlerëson të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur për t'u tërhequr nga kandidimi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, vendosi dërgimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 245, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. *Emona Muçi* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
7. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur

relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ndërkohë që zoti Koça rikthehet për shqyrtimin e kësaj pike. Për më tej fjalën për të z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës paraqesim projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Në relacionin përkatës kemi shpjeguar me hollësi procedurën që nga momenti i vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor për shpalljen e vendeve vakante për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë shtatë pozicione në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për tre pozicione në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione në fushën e të drejtës penale, me vendimet përkatëse 73 – 81, 20.02.2024. Afati i kandidimit ka qenë 2 javë. Është mbyllur më datën 01.03.2024. Rezulton nga verifikimet se brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr. 84 dhe nr.86, datë 20.02.2024 kandidon edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati) gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 84/2024, 86/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr. 140, datë 13.03.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1

(një) vlerësim. Caktimin e relatorit për kandidatin zotin {...}, të anëtarit Markelian Koça.

Më datë 18.03.2024, është njoftuar në rrugë elektronike magjistrati në lidhje me i) fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) caktimin e relatorit; iii) të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të anëtarëve të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Me marrjen dijeni nuk është paraqitur asnjë kërkesë, as pretendim në lidhje me relatorin dhe anëtarët e Këshillit.

Në vijim të procedurës, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkuua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të komunikimit elektronik të datë 19.03.2024, ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}.

Nga rezultatet e verifikimit të kritereve të kandidimit rezulton se në lidhje me lidhje me kriterin e “Përvojës profesionale specifike minimale”, duke mos përsëritur përcaktimet ligjore rezulton që magjistrati ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 465, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtar. Me vendimin nr. 510, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me vendimin nr. 140, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në datë 16.10.2023 është zgjedhur Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, funksion të cilin ushtron edhe në këto momente që po paraqesim relacionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit është 3 vite. Rezulton që nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në relacion janë caktuar në mënyrë analitike numri total i çështjeve të shqyrtuara dhe përfunduara nga magjistrati për secilin vit kalendarik 2020-2021, 2022, 2023, për shkak të specifikave, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nuk ka funksionuar me dhoma të ndara civile dhe penale, pra gjyqtarët kanë gjykuar çështje si të natyrave civile ashtu edhe të natyrës penale.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.84 dhe nr. 86 datë 20.02.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile dhe penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

U verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Rezulton që në lidhje me këtë kriter kandidati ishte duke depozituar formularin e vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Është verifikuar kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” dhe ka rezultuar që gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku është administruar edhe deklarimi personal që nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë.

Është marrë në shqyrtim dokumentacioni i plotë për kandidatin nga ana e Komisionit dhe relatimin e relatorit dhe në datën 27.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, bazuar në pikën 63, të Seksionit Ç, Kreu V, të vendimit 320/2020, si dhe në pikën 10, të vendimeve nr.84 dhe nr.86, datë 20.02.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare duke propozuar plotësimin e kriterëve nga ana e kandidatit. Është përcjellë edhe projektvendimi i konceptuar në dy pika:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës paraqesim projektvendimin, titulli i të cilit u relatua nga kryesuesi i seancës.

Po kalojmë në relacion.

Qëndrojnë të njëjtat situata sikundër për zotin {...}.

Me Vendimin nr.73 - nr.86 datë 20.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Brenda afatit të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që përfundoi më datë 01.03.2024, rezulton të ketë paraqitur kandidim për pozicionin e lirë nr. 86, datë 20.02.2024, z. {...} (më poshtë referuar si kandidati) gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, bazuar në përcaktimet ligjore Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr. 140, datë 13.03.2024, të Këshillit është vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim, ku përfshihet edhe zoti {...}. Është caktuar si relator z. Markelian Koça.

Më datë 18.03.2024, në respektim përcaktimeve ligjore, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) të drejtën që kishte për të kërkuar

përrjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e njoftimit.

Është njoftuar rregullisht për sa më lart dhe nuk rezultojnë që të ketë paraqitur pretendime lidhur me relatorin apo ndonjë anëtar tjetër të Këshillit.

Në vijim është kërkuar dhe administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të komunikimit elektronik të datës 19.03.2024, ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet në vijim.

Në lidhje me rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit, rezultojnë se zoti {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit “Luarasi” në datë 03.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendimin nr. {...}, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtar. Me vendimin nr. {...}, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Me vendimin nr. 98, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe prej datës 01.05.2023 ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Me vendimin nr. 102, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në 13.03.2025. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me përvojën specifike të punës nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nga verifikimet e kryera rezultojnë se: “Gjatë kohës që gjyqtari {...} ka ushtruar këtë funksion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka gjykuar çështje të natyrës civile dhe penale njëkohësisht. Kjo për faktin se Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Kurbin për shkak të trupës së saj gjyqësore me numër të vogël nuk ka qenë e ndarë në dhoma apo seksione konkrete për gjykimin e çështjeve që vinin për gjykim. Për këtë arsye gjyqtarët që përbenin trupën gjyqësore të kësaj gjykate gjykonin çështje civile dhe penale sipas shortit elektronik.”

Në lidhje me përvojën specifike nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se në vitin 2023 ka gjykuar 33 çështje penale themeli dhe 114 kërkesa penale, ndërsa për vitin 2024 deri në fund të muajit janar ka gjykuar 1 çështje themeli dhe 2 kërkesa penale. Gjatë periudhës së muajit gusht 2023 ka qenë pjesë e grafikut për çështjet civile dhe penale me karakter urgjent.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se zoti {...} ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Në lidhje me kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” është administruar vetëdeklarimi “Për masa disiplinore” datë 28.02.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Nga informacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se z. {...} nuk ka masë disiplinore.

Nga dokumentacioni i administruar në tërësi gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, është administruar edhe deklarimi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, deklaratë e datës 28.02.2024.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Pas verifikimeve është dërguar materiali për shqyrtim në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës dhe në mbledhjen e datës 27.03.2024, komisioni ka konkluduar se plotësohen kriteret nga ana e z. {...} dhe ka vendosur për sjelljen e materialit për mbledhjen plenare. Bashkëlidhur keni vendimin e konceptuar edhe ky në dy pika si për z. {...}, kështu që nuk po zgjatem ta lexoj nga e para sepse është i njëjti model, ndryshon vetëm vendimi, vendi/pozicioni nr. 86, 20.02.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës po paraqesim projektvendimin Për kualifikimin e kandidatit {...}. Titulli u lexua nga zëvendëskryetari.

Jemi në të njëjtat rrethana me z. {...} sepse kandidojnë edhe për të njëjtin vend, pozicionin nr.86 datë 20.02.2024. Kështu që po e kaloj pjesën e përshkrimit ligjor dhe kaloj direkt tek konstatimet nga ana e Komisionit.

Brenda afatit ligjor zoti {...} ka paraqitur kërkesë. Është njoftuar për fillimin e procedurës, për të drejtën e kundërshtimit të relatorit pra për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo anëtarëve të Këshillit. Brenda afatit ligjor ka marrë dijeni. Nuk ka paraqitur pretendim. Është kërkuar dokumentacioni përkatës në lidhje me përvojën profesionale dhe mospasjen e masave disiplinore dhe rezulton nga verifikimi se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datë 05.10.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në Shkenca Penale pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 12, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 56, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Me vendimin nr. 129, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, nga data 01.05.2023 ushtron detyrën si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër në datë 25.10.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër Durrës (*lapsus, është Dibër*), detyrë që e ushtron edhe aktualisht. Ka gjithsej katër vite vjetërsi pune. Nuk ka masa disiplinore.

Nga verifikimet rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale. Në relacion janë paraqitur edhe në mënyrë specifike çështjet e gjykuara për çdo vit. Ka të njëjtën specifike gjykata e Dibrës

për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, janë gjykuar nga të njëjtë gjyqtarë çështjet civile dhe penale.

Për masat disiplinore kemi administruar deklaratën datë 26.02.2023 (*lapsus, vitit 2024*), se nuk ka masa disiplinore. Dhe nga verifikimet në Departamentin e Burimeve Njerëzore rezultoi që nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me kriterin e “papajtueshmërisë ambientale” është administruar deklaratën se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe nga verifikimet po ashtu rezultoi se nuk ka ndonjë situatë papajtueshmërie ambientale. Në këto kushte, vlerësohet që i plotëson kriteret e përcaktuara.

Është paraqitur relacioni për Komisionin i cili në vijim në mbledhjen e datës 27.03.2024 ka vendosur konstatimin e ekzistencës së plotësisimit të kriterëve ligjore në procedurën e verifikimit të z. {...} dhe përcjelljen për mbledhjen plenare. Gjithashtu keni bashkëlidhur edhe vendimin me të njëjtën përmbajtje si për z. {...}. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord. (e ripërsërit)

Yllka Rupa: Pro. (e ripërsërit)

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord me prezantimin e relacionit.

Ilir Rusi: z. Kurushi sapo votoi.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.85, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.85, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.85, datë

20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Zoti {...} është një nga kandidatët potencial për pozicionin nr.85, datë 20.02.2024, pozicion i lirë pranë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (fusha penale), i iniciuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Për të janë kryer disa veprime procedurale.

Me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, ai figuron në listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike.

Me Vendimin nr. 140, datë 13.03.2024 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit duke u caktuar edhe relatori përkatës.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilët do të provonin plotësimin e kriterëve formale të parashikuara nga nenet 43/6, 8/3 të ligjit “Për statusin”.

Nga aktet e administruara rezulton se kandidati z. Çela ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010. Me dekret nr. {...}, datë 27.09.2010 të Presidentit të Republikës caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. {...}, datë 21.12.2011 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendim nr. {...}, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 01.03.2022 ku në këtë pozicion është zgjedhur z. Shehu, dhe në vijim ka ushtruar funksionin e magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër). Aktualisht nuk figuron të ketë masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën e posaçme ju kam pasqyruar në mënyrë të detajuar urdhrat e brendshëm të gjykatës ku në mënyrë konsekuente ky kandidat figuron pjesë e dhomës penale. Kështu që nga të dhënat rezulton që zoti {...} deri në momentin e kandidimit për lëvizje paralele për këtë pozicion të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike

minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Nuk ka masa disiplinore dhe nuk ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në këtë kuadër është përgatitur projekti ku ju sugjerohet kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.85, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.85, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |

9. Emona Muçi (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet

nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Zonja {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kandidon për pozicionet e lira të hapura nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Tiranës dhe Durrës (fusha civile). Bëhet fjalë për pozicionet nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024. Edhe për këtë janë bërë disa veprime procedurale.

Me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, figuron në listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit.

Me Vendimin nr. 140, datë 13.03.2024 ka filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit duke u caktuar edhe relatori përkatës.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilët do të provonin plotësimin e kritereve formale të parashikuara nga nenet 8/3, 43/6, të ligjit “Për statusin”.

Nga aktet e administruara rezulton se që znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 26.03.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016. Me dekretin nr. {...}, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. {...}, datë 20.01.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtare. Me vendimin nr. {...}, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë caktohet për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja për periudhën e ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve pasi kjo gjykatë nuk ka pasur ndarje në dhoma e seksione. Për periudhën e ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier maj 2023 e në vijim sipas vendimit datë 16.05.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ka gjykuar në seksioni penal); Vendimin nr. {...} prot. datë 31.10.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ka gjykuar në seksioni civil); Vendimin nr. {...} prot. datë 31.01.2024 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ka gjykuar në seksioni civil).

Pra Nga të dhënat që administruam, rezulton që plotëson përvojën profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Edhe për kandidaten u verifikuar kriteret e mospasjes masë disiplinore në fuqi. Nuk rezulton të ketë në fuqi një masë disiplinore. Ndërkohë që nga Inspektorati i Lartë me vendimin nr. {...}, datë 12.09.2023 ka filluar një hetim disiplinor për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit 96/2016.

Gjithashtu nuk rezulton të ekzistojë edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale i tillë që të mund të pengojë kandidimin e mëtejshëm të saj.

Në këto kushte, ana e relatorit është përgatitur drafti i vendimit, bazuar në aktet që aktualisht janë administruar dhe ku propozohet që znj. {...} kualifikohet dhe vijon procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024 të KLGJ-së.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.74, nr. 82 dhe nr. 83 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Zoti {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është një nga kandidatët për pozicionin nr. 86 datë 20.02.2024 të hapur nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (fusha penale). Edhe për këtë kandidat janë kryer disa veprime procedurale.

Me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, figuron në listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale.

Me Vendimin nr. 140, datë 13.03.2024 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve edhe bazë të saj edhe relatori përkatës.

Me cilësinë e relatorit janë administruar aktet e nevojshme të cilët do të provonin plotësimin e kriterëve formale të parashikuara nga nenet 8/3, 43/6, të ligjit “Për statusin”.

Nga aktet e administruara rezulton se kandidati {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 19.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E Drejtë Publike”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendimin nr. 132, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 148, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datë 07.04.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Vjetërsia është 4 vite. Nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “Nga verifikimi i regjistrit të personelit për Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë rezulton se magjistrati {...}, në bazë të vendimit nr. 148, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë nga dita e emërimit gjyqtar datë 19.07.2019. Për periudhën nga viti 2019 e në vijim Gjykata e Shkallës së Parë e

Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (seksion civil/seksion penal), por ka qenë e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale. Me vendimin nr. {...} prot., datë 24.12.2020 të këshillit të gjykatës “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka funksionuar si seksion vetëm seksioni penal për të mitur, gjyqtarët e të cilit do të gjykojnë çështjet penale me të pandehur të mitur dhe viktimat të mitur, pjesë e këtij seksioni është dhe kandidati {...}”.

Nga të dhënat e administruara deri në këtë moment, rezulton që ai të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu u verifikua nëse ka masa disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale të cilat nuk rezultojnë të jenë verifikuar.

Në këto kushte ju propozohet kualifikimi dhe vijimi i procedurës së mëtejshme të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimin nr. 86, datë 20.02.2024 të KLGJ-së.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.80, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.80, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 13 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.80, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Për pozicionin e lirë të shpallur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele ka kandiduar edhe zonja Lice, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Kjo kandidate figuron sipas vendimit nr. 127, datë 11.03.2024, në listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit.

Me Vendimin nr. 140, datë 13.03.2024 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit duke u caktuar edhe relatori përkatës.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet e nevojshme të cilët provojnë plotësimin e kriterëve formale të parashikuara nga nenet 8/3, 43/6, të ligjit “Për statusin”.

Nga aktet e administruara rezulton se kandidatja Lice ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 07.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekretin nr. {...}, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 09.02.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si Zëvendëskryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 12 vite. Nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Ndërkohë në lidhje me përvojën specifike ju kam paraqitur në mënyrë të detajuar urdhrat e kryetarit të gjykatës ku figuron pjesë e dhomës penale dhe nga këto akte rezulton që kandidatja të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës penale në 5 vitet e fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë masë disiplinore apo papajtueshmëri ambientale, kushte të cilat nëse do të verifikoheshin do të pengonin konkurrimin e mëtejshëm.

Në këto kushte ju propozohet kualifikimi dhe vijimi i procedurës së mëtejshme të lëvizjes paralele për atë pozicion të lirë që cituam më lart.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.80, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.80, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

98

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.04.2024 (Pika 14)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 14 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë

Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Zonja {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është një nga kandidatet për pozicionet e lira nr.79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të hapura pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Edhe për këtë kandidate janë administruar aktet, si është vendimi nr. 127, datë 11.03.2024, ku Këshilli e ka përcaktuar në listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale apo vendimi nr. 140, datë 13.03.2024 në bazë të të cilit ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit të saj.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilët do të provojnë plotësimin e kriterëve të parashikuara nga nenet 8/3, 43/6, të ligjit “Për statusin”.

Nga administrimi i këtyre akteve ka rezultuar se znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2005 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Me dekretin nr. {...}, datë 05.10.2007 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Me dekretin nr. {...}, datë 25.03.2009 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendimin nr. 105, datë 25.03.2021 të Këshillit të Larë Gjyqësor caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një periudhë deri në 25.03.2022. Me vendimin nr. 113, datë 28.03.2022 të Këshillit të Larë Gjyqësor ricaktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një periudhë deri në 25.03.2023. Me vendimin nr. 46, datë 27.01.2023 të Këshillit të Larë Gjyqësor deklarohet përfundimi para afatit të shërbimit në skemën e delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, duke filluar nga data 01.02.2023 dhe rikthehet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendimin nr. 134, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate. Vjetërsia është 16 vite. Nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Ndërkohë në lidhje me përvojën specifike profesionale në 5 vitet e fundit ka rezultuar se “Është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe ka filluar punë në datë 18.10.2007. Gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në shkallë të parë ka qenë pjesë e seksionit penal në periudhat 2009-2011, 2012-2015, 2018 deri në 18.03.2019. Për periudhën nga data 18.03.2019 e në vijim Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka funksionuar e ndarë në seksione por ka qenë e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale. Gjyqtare {...} ka gjykuar të gjithë natyrën e çështjeve gjyqësore. Me vendimin nr. {...} prot., datë 24.12.2020 të këshillit të gjykatës “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka funksionuar si seksion vetëm seksioni penal për të mitur, gjyqtarët e të cilit do të gjykojnë çështjet penale me të pandehur të mitur dhe viktima të mitur, pjesë e këtij seksioni ka qenë edhe znj. {...}”.

Në lidhje me përvojën specifike në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se znj. {...} ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën 25.03.2021-01.03.2023 dhe gjatë kësaj periudhe kjo gjyqtare ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve (civile, kërkesa civile, penale, kërkesa penale etj.), pasi gjyqtaret e kësaj gjykate nuk ishin të ndarë në dhoma apo seksione.

Pra përfundimisht ajo rezulton të ketë përvojën profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile dhe penale gjatë 5 viteve të fundit.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale, verifikime do të pengonin konkurrimin e mëtejshëm të saj.

Në përfundim ju propozohet kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele më tej.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi (relatohet në mbledhje nga z. Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

103

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.04.2024 (Pika 15)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
7. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi (relatohet në mbledhje nga z. Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 15 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur

relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej do vazhdojë relatimi nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Alban Toro: Faleminderit zoti Rusi!

Zoti {...} është një nga kandidatët i cili kandidon për pozicionin nr. 80 dhe nr. 81 të hapura me procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të drejtën penale.

Edhe për të janë kryer disa veprime procedurale ku spikat vendimi nr. 127 datë 11.03.2024, i cili identifikon si kandidat që ka ose mund të ketë dy vlerësime etike dhe profesionale. Me vendimin nr. 140, datë 13.03.2024 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidatit nga procedurat e lëvizjes paralele si dhe ka caktuar relatorin përkatës.

Nga relatori janë administruar aktet të cilët do të provojnë plotësimin e kritereve të parashikuara nga nenet 43/6, 8/3, të ligjit “Për statusin”.

Nga këto akte rezulton se z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 29.03.1994. Me vendimin nr. {...}, datë 24.11.1993 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtar efektive pranë Gjykatës së Rrethit Burrel. Me vendimin nr. {...}, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet gjyqtar dhe Zëvendëskryetar në Gjykatën e Rrethit Mat. Me vendimin nr. {...}, datë 22.04.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 11.10.2013. Me vendimin nr. {...}, datë 11.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Me vendim nr. 5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pezullohet nga detyra për një periudhë 1-vjeçare për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe me vendimin nr. 444, datë 16.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmohet në detyrë. Me vendimin nr. 129, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia 30 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, nga aktet e administruara rezulton se “Gjyqtari {...} ka filluar të ushtrojë funksionet e gjyqtarit pranë ish-Gjykatës së Shkallës së Parë Mat me datën 30.03.1995. Nga data 22.04.2008 – 24.07.2020, ka ushtruar funksionet e Kryetarit të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Me vendimin e ndërmjetëm të KPK-së, gjyqtari {...} është pezulluar nga detyra për një periudhë 1-vjeçare duke u riintegruar përsëri në trupën gjyqësore me vendimin nr. 444 të KPK-së datë 16.09.2021. Nga data 16.09.2021-28.04.2023, ka ushtruar funksionin e kryetarit të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Nga data 02.05.2023 e në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve (7 gjyqtarë) nuk ka seksione, por gjyqtarët gjykojnë të gjitha çështjet (civile, penale, penale-administrative). Gjithashtu, ish-Gjykata e Shkallës së Parë Mat nuk ka pasur seksione për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve (4 gjyqtarë). Në këto rrethana, z. {...} i ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve (penale/civile /administrative). Në këto kushte, po ju dërgojë statistikën të cilat janë administruar në mënyrë tabelare në relacion.

Nga këto informacione rezulton që z. {...} gëzon përvojën profesionale minimale në fushën e të drejtës penale në pesë vitet e fundit. Nuk ka masa disiplinore apo verifikim të kriterëve të papajtueshmërisë ambientale që do ta pengonin konkurrimin e tij. Kështu që nga relatori ju propozohet kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin nr. 80, nr. 81, datë 20.02.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 73, nr.75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

108

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.04.2024 (Pika 16)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 73, nr.75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 16 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 73, nr.75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të

cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës paraqes relacionin për vendimin e cituar nga ana juaj.

Rezulton se zonja {...} kandidon për vendimet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nr. 73, nr. 75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024, Rezulton që brenda afatit janë paraqitur kërkesat e shprehjes së interesit të saj.

Në vijim me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë përfshihet znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, prej marsit të vitit 2023.

Është njoftuar për fillimin e procedurës, për emrin e relatorit dhe për të drejtën e përjashtimit të relatorit apo anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nuk ka paraqitur ndonjë pretendim në lidhje me të, mbi sa më lart me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, për fillimin e procedurës së verifikimit dhe caktimin e relatorit përkatës.

Është kërkuar informacioni lidhur me përvojën profesionale minimale specifike dhe për eventualisht pasjen e masave disiplinore, rezulton nga verifikimet se znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014. Me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 209, datë 20.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i miratohet kërkesa për leje prindërore për periudhën 14.06.2021-31.12.2021. Me vendimin nr. 595, datë 23.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i miratohet kërkesa për zgjatje të afatit të lejes prindërore, deri në datë 31.07.2022. Me vendimin nr. 268,

datë 19.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i miratohet kërkesa për zgjatje të afatit të lejes së papaguar prindërore, deri në datë 31.03.2023. Me vendimin nr. 442, datë 01.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i ndërpritet leja e papaguar prindërore, dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 93, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë 1 (një) vjeçare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Me vendimin nr. 105, datë 29.02.2024 (*lapsus 2014*) të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm për një periudhë 1 (një) vjeçare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit, 10 vite.

Nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me përvojën specifike në 5 vitet e fundit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier rezulton: “Prej tetorit 2015 është pjesë e dhomës civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton me urdhrin nr.68, datë 10.03.2023 të Këshillit të Gjykatës është caktuar në seksionin civil/tregtar në Dhomën Civile.

Nga të dhënat për sa më lart rezulton të ketë mbi 1 vit përvojë profesionale specifike minimale në fushën e të drejtës civile gjatë 5 viteve të fundit.

Nga verifikimet ka rezultuar se nuk ka masë disiplinore. Ka plotësuar deklaratën sipas kërkesave ligjore dhe njoftimit për vendet vakante.

Gjithashtu konstatohet se nuk është në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nga verifikimet e kryera nga ana e Komisionit.

Për këtë arsye përcillet për shqyrtim në mbledhjen plenare për kualifikimin dhe vijimin e procedurës për pozicionet nr. 73, nr. 75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 73, nr.75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 75 dhe nr. 78, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 17 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi (në mbledhje relatohet nga z. Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. Emona Muçi (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.**
6. **Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.**
7. **Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

17. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi (në mbledhje relatohet nga z. Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 17 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin

nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit në vijim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Alban Toro: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka iniciuar procedurat e lëvizjes paralele për plotësimin e vendeve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, ndër to për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024 ka konkurruar edhe z. {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Për të janë kryer disa veprime procedurale.

Ai figuron në listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale parashikuar në vendimin nr. 127, datë 11.03.2024 apo vendimi nr. 140, datë 13.03.2024 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit të tij në procedurën e lëvizjes paralele duke u caktuar edhe relatori përkatës.

Relatori ka administruar aktet të cilat do të provojnë plotësimin e kriterëve të parashikuara nga nenet 8/3, 43/6, të ligjit “Për statusin”.

Nga këto akte rezulton që z. {...} përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016. Me dekretin nr. {...}, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. {...}, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë Drejtësisë caktohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, datë 18.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me vendimin nr. 134, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin si gjyqtar. Vjetërsia 8 vite.

Nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, ka rezultuar se: “Nga verifikimi i regjistrit të personelit për ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Pogradec rezulton se magjistrati {...}, në bazë të dekretit nr. {...}, datë 10.02.2017 të KLD-së, ka filluar punë në datë 10.02.2017 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Për periudhën nga viti 2010 e në vijim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (seksion civil/seksion penal), por ka qenë e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale. Pas datës 01.05.2023 gjyqtari {...} është pjesë e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Gjykata funksionon e ndarë në trupa gjykues. Pra nga informacioni i mësipërm, në kushtet kur në Gjykatë e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka pasur ndarje në seksioni, kandidati z. {...} ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve penale e civile”. Pra ai plotëson edhe këtë kriterin minimal të një vit përvojë profesionale gjatë 5 viteve të fundit përpara kandidimit.

Nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale, kritere që do të ndalonin konkurrimin e mëtejshëm të tij.

Në këtë kuadër ju propozohet nga ana e relatorit kualifikimi i kandidatit {...} dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 17 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.04.2024)

Pika 18 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 15:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

18. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 18 të këtij rendi dite, që është edhe pika e fundit e tij, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin

është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Nga materiali që kemi vënë në dispozicion rezulton se z. {...} kandidon për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e të drejtës civile.

Zoti {...} ka kandiduar brenda afatit të përcaktuar nga ana e Këshillit për këtë pozicion. Aktualisht është me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Është pjesë e listës së miratuar nga Këshilli me vendimin nr. 127, 11.03.2024 të kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë.

Më parë rezulton që ka kandiduar për pozicionin e ngritjes në detyrë dhe z. {...} me paraqitjen e aplikimeve të reja ka njoftuar së bashku me këtë aplikim se ka hequr dorë nga kandidimi për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pozicioni nr. 499, datë 21.11.2022, kërkesë për të cilën është shprehur edhe Këshilli me vendimin nr. 125, 11.03.2023.

Në vijim me vendimin nr. 140, 13.03.2023 ka filluar procedurën e verifikimit ku është caktuar relatori me procedurën e shortit. Është njohur me sa më lart. Nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me relatorin dhe anëtarët e Këshillit.

Janë kryer verifikimet nga ana e Komisionit në lidhje me përvojën profesionale minimale specifike, për masat disiplinore dhe papajtueshmërinë ambientale.

Nga verifikimet rezulton se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Me dekretin nr. {...}, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me

vendimin nr. {...}, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Me vendimin nr. 176, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimi në pozicion e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Nuk rezulton pasja e masave disiplinore.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, është administruar dokumentacioni përkatës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ku ka qenë në skemë dhe rezulton që në përfundim të verifikimeve plotëson kriterin minimal të përcaktuar nga ligji për t’u kualifikuar.

Po ashtu rezulton që nuk ka masa disiplinore. Është administruar edhe vetëdeklarimi i datës 01.03.2024 dhe nga verifikimi po ashtu nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se nuk ka masë disiplinore.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale është administruar deklarimi sipas formularin. Për këtë rast sqarojmë se në relacion kemi vënë në dijeni se bashkëjetuesja e z. {...}, znj. {...} është magjistrate, ushtron funksionin e gjyqtarit në seksionin penal në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në këtë rast komisioni merr në konsideratë këto kritere:

i) mënyrën sesi ushtrojnë funksionet gjyqtarët në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Funksionet e gjyqtarëve janë totalisht të dallueshme dhe pa interferuar tek puna e detyrat e njëri-tjetrit; gjyqtarët e seksionit civil gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si gjyqtarë në Gjykatën e Tiranës, nuk kanë lidhje, ndikim, mbivendosje, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo në mënyrë të tërthortë, me funksionet që ushtrojnë gjyqtarët e seksionit penal në Gjykatën e Tiranës; ii) Në Gjykatën e Tiranës, në raport me gjykatat e tjera të Republikës së Shqipërisë, gjyqtarët e seksionit civil ushtrojnë funksionin në ambiente/godina të ndryshme me atë të seksionit penal; iii)

numrin relativisht të lartë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në këtë gjykatë; - që e bën eventualisht të pamundur situatën e konfliktit ambiental.

Në këto kushte, duke vlerësuar këto specifika për Gjykatën e Tiranës, në raport me gjyqtarët e gjykatave të tjera të rretheve gjyqësore, referuar selive dhe kritereve ligjore, ambienteve, vlerësohet se në këtë rast nuk shkelet parimi i papajtueshmërisë ambientale parashikuar nga neni 8 i ligjit “Për statusin”.

E në këto kushte i përcjellim mbledhjes plenare projektvendimin për kualifikimin e z. {...} për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë tek votimi i projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të këtij rendi dite, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

* * *

(Pika 18 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor